

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5595  
E shtunë, 6 tetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Lulzim Tafa dekorohet me Medaljen Presidenciale të Meritave



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)


FLET PËR "EPOKËN E RE", GANIMETE MUSLIU | FAQE 4-5

## Qeverinë mund ta rrëzojë vetëm pozita

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka thënë se opozita nuk ka asnjë shans ta rrëzojë Qeverinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se paralajmërimet e opozitës për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë janë vetëm përpjekje për ta tërhequr vëmendjen e opinionit publik. Sipas saj, Qeveria Haradinaj mund të shkojë te shtëpia vetëm nëse këtë e duan partnerët e koalicionit qeverisës. Deputetja Musliu ka lavdëruar Qeverinë Haradinaj duke thënë se vetëm për tre muaj ky kabinet qeveritar ka bërë sa Qeveria e kaluar në gjithë mandatin e saj. "Qeverinë mund ta çojë në shtëpi vetëm koalicioni qeverisës, pra pozita. Asnjëherë këtë Qeveri nuk mund ta rrëzojë kjo opozitë", ka thënë Musliu



## AKTUALE



**QOSJA: NË BISEDIMET ME  
SERBINË NUK DILET ME  
DEKLARIME MOHUESE NDAJ  
LUFTËS ÇLIRIMTARE F. 5**

**MOLLIQAJ: PARTIA  
SOCIALDEMOKRATE DO TË  
KETË 27 DEGË DERI NË  
DHJETOR F. 6**

## EKONOMI

**REFORMAT E MINISTRISË  
SË FINANCAVE PO JAPIN  
EFEKTET NË ZHVILLIMIN  
EKONOMIK TË VENDIT F. 8**

**DOGANA PËR NËNTË MUAJ  
MBLODHI 837 MILIONË EURO  
F. 10**

## KULTURË

**NJË SKËNDERBE NDRYSHE  
NË NJË ALBUM TË HUAJ F. 6**

Mirsad R. Dakaj

## SPORT

**SHILLOVA SYNON EPITETIN E  
GOLASHËNUESIT DHE KREUN  
ME FLAMURTARIN F. 15**

LIDERËT SHTETËRORË VAZHDOJNË TË KENË QËNDRIME TË  
NDRYSHME LIDHUR ME IDENË E KORRIGJIMIT TË KUFIRIT  
KOSOVË - SERBI

## Haradinaj dhe Veseli njëzëri sërish kundër korrigjimit të kufirit me Serbinë | FAQE 3

Edhe të premtën ka vazhduar debati lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Përderisa presidenti i vendit, Hashim Thaçi, vazhdon ta promovojë idenë për korrigjimin e kufirit me Serbinë, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj insistojnë për ruajtjen e territorit të Republikës së Kosovës. Ata kanë thënë se u kanë borxh dëshmorëve t'i ruajnë kufijtë e shtetit të Kosovës



## UÇK-ja të pamundurë n e bëri realitet

Me rastin e inaugurimit të Kompleksit Memorial të Dëshmorëve dhe Heronjve të Kombit në Marinë të Skenderajt, presidenti Hashim Thaçi ka ndarë urdhrin "Hero i Kosovës" për 158 dëshmorët e varrosur në këtë kompleks

FAQE 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Rrahman Rama foli për tranzicionin e FSK-së në konferencën 'Karta e Adriatikut A5'

**BUDVË, 5 TETOR** - Komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama, ka marrë pjesë në takim vjetor të shefave të mbrojtjes në kuadër të 'Kartës së Adriatikut A-5' që u mbajt në Budva, Mali i Zi, nga data 3 deri më datën 5 tetor.

Gjeneralletënant Rrahman Rama, në adresimin e tij në kuadër të konferencës 'ShBA-Karta e Adriatikut A5', i ka njoftuar homologët e vet lidhur me tranzicionin e FSK-së dhe për zgjerimin e kompetencave të saj.

Rama me theks të veçantë ka folur për nevojën e zgjerimit të bashkëpunimit në nivel rajonal, me qëllim të rritjes së ndërveprueshmërisë, besimit dhe shkëmbimit të përvojave në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes.

Komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama, dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Timothy Orr, të shoqëruar edhe nga atasheu ushtarak amerikan, koloneli Nichols Ryan, zhvilluan një



takim të përbashkët me zëvendëskomandantin e Komandës së Ushtrisë amerikane për Evropë (EUCOM), gjeneralletënant Stephen M. Twitty, ku së bashku diskutuan për marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe. Me këtë rast, gjeneral Rama e ka njoftuar gjeneralin

Twitty lidhur me procesin e tranzicionit, zhvillimin profesional të FSK-së, integrimin e komunitetit joshumicë, bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me Gardën Kombëtare të Ajovës - ShBA si dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet FSK-ja.

## Mustafa: Po bëhemi gati ta rimarrim qeverisjen e vendit

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se partia e tij po bëhet gati ta rimarrë qeverisjen e vendit, duke ofruar zgjidhje evropiane për proceset që na presin, duke shtuar se LDK-ja e ka thënë qartë se tani në asnjë rast nuk do të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë, as në ekipin e presidentit dhe as të Qeverisë

**PRISHTINË, 5 TETOR** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se nga ky muaj kanë filluar ta shtojnë punën me strukturat e partisë. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se kanë diskutuar për prioritetet të cilave duhet t'u përmbahet LDK-ja në komuna dhe në nivel qendror dhe, siç ka thënë ai, për ndryshimet që duhet të ndodhin, në mënyrë që



Kosova të qeveriset mirë e pa korrupsion. "Po shkëmbejmë mendime me strukturat dhe anëtarësinë e LDK-së për temat me rëndësi të veçantë për Kosovën. Po bëhemi gati ta rimarrim qeverisjen e vendit, duke ofruar zgjidhje evropiane për proceset që na presin. Në zgjedhjet lokale të vitit të

kaluar LDK-ja doli bindshëm parti e parë. Të gjitha sondazhet e këtij viti, po ashtu, flasin se kemi besimin më të madh të qytetarëve. Por kjo nuk e mbron LDK-në nga marrëveshjet e fshehta dhe manipulimet që mund t'i bëjë PDK-ja në zgjedhjet e ardhshme. Prandaj duhet të punojmë shumë me anëtarësinë dhe qytetarët për ta shtu-

ar besimin e tyre në fitoren tonë të përbashkët", ka thënë Mustafa.

Ai ka shtuar se LDK-ja e ka thënë qartë se tani në asnjë rast nuk do të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë, as në ekipin e presidentit dhe as të Qeverisë. "Do të punojmë që zgjedhjet e parakohshme të ndodhin sa më shpejt, sepse LDK-ja ndan bindjen e pjesës dërrmuese të qytetarëve të Kosovës, se qeverisja e tanishme e vendit është e dëmshme për Kosovën dhe ardhmërinë e saj. Deri në shpartallimin e këtij koalicioni LDK-ja nga këndi i opozitës do t'i mbrojë interesat e vendit, në bashkëpunim edhe me partitë e tjera që i qëndrojnë besnike opozitarizmit", ka deklaruar Mustafa.

### LAJME SHKURT

#### Stoltenbergu: Asgjë nuk do të bëhet që do të destabilizonte rajonin

**Lubjanë, 5 tetor** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i pyetur për shkëmbimin e territoreve dhe ndryshimin e kufijve në Ballkanin



Perëndimor, ka deklaruar se "asgjë nuk do të bëhet që do të destabilizonte rajonin", ka njoftuar agjencia slllovene STA. "Besoj se procesi i normalizimit të marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit është thelbësor për paqen në rajon dhe sigurinë dhe se të gjithë aleatët e NATO-s pajtohen se është me rëndësi që ai të vazhdojë", ka thënë Stoltenbergu të premten në mbrëmje në Lubjanë. Sipas tij, liderët politikë në rajon kanë një rol shumë të rëndësishëm e që përfshin më shumë përpjekje drejt pajtimit. "Ardhmëria e gjithë Ballkanit Perëndimor është në familjen euroatlantike", ka thënë shefi i NATO-s, Stoltenbergu. Ndërkaq, sa i përket Maqedonisë, Stoltenbergu ka thënë se bisedimet do të vazhdojnë, mirëpo "e vetmja mënyrë që Shkupi t'i bashkohet NATO-s është konfirmimi dhe zbatimi i marrëveshjes për emrin me Greqinë në tërësi".

#### Juncker: Mund të ketë luftë në Ballkan

**BRUKSEL, 5 TETOR** - Shefi i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, paralajmëroi të premten për rrezikun e shpërthimit të konflikteve të reja të



armatosura në Ballkan nëse Bosnja, Shqipëria, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova nuk e ndiejnë se BE-ja është serioze për t'u ofruar atyre anëtarësim në të ardhmen. "Nëse në rajonin shumë të komplikuar të Evropës krijohet përshtypja se nuk jemi seriozë për ofrimin e perspektivës evropiane, atëherë mund të shohim më vonë, ndoshta edhe më shpejt, atë që pamë në Ballkan në vitet 1990", tha Junckeri. Ai theksoi se historia e viteve 1990 ende nuk është zotëruar në Ballkan. "Historia e viteve '90 mund të lindë sepse e kaluar e dekadave të mëparshme, shokujve, nuk është tejkaluar", ka thënë shefi i Komisionit Evropian, Juncker. Gjashtë shtetet e Ballkanit, të cilat gjatë viteve 1990 formuan fushën e betejës në konfliktin më vdekjeprurës të Evropës që nga Lufta e Dytë Botërore që çuan në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, janë aktualisht në faza të ndryshme të bisedimeve të pranimit me BE-në.

## Drogë nga Maqedonia drejt Kosovës, sekuestrohen 108 kilogramë hashash

**Prishtinë, 5 tetor (ER)** - Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka sekuestruar një sasi prej 108 kilogramësh lëndë narkotike kanabis sativa pas një operacioni në Dimcë të

Hanit të Elezit, por nuk ka mundur t'i arrestojë poseduesit e drogës.

Policia e Kosovës ka njoftuar se droga kishte hyrë në Kosovë nga territori i Maqedonisë me

një makinë. "Pasi policia ka vërejtur makinën, ajo është kthyer prapa, mirëpo në vendin e ngjarjes janë gjetur gjashtë çanta, ku brenda tyre kishte 95 paketime me sub-

stanca narkotike", është theksuar në njoftimin e policisë. Policia më pas ka bërë peshimin e drogës, e cila rezultoi të jetë 108 kilogramë e 13.3 gramë marijuanë.



Liderët shtetërorë vazhdojnë të kenë qëndrime të ndryshme lidhur me idenë e korigjimit të kufirit Kosovë - Serbi

# Haradinaj dhe Veseli sërish kundër korigjimit të kufirit me Serbinë



Edhe të premten ka vazhduar debati lidhur me idenë për korigjimin e kufirit me Serbinë.

Përderisa presidenti i vendit, Hashim Thaçi, vazhdon ta promovojë idenë për korigjimin e kufirit me Serbinë, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj insistojnë për ruajtjen e territorit të Republikës së Kosovës. Ata kanë thënë se kanë borxh ndaj dëshmorëve për liri dhe pavarësi për ruajtjen e kufijve të shtetit të Kosovës

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 TETOR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, vazhdon të insistojë për realizimin e idesë për korigjimin e kufirit me Serbinë. Edhe të premten ai ka bërë me dije se është duke u angazhuar që korigjimi i kufirit, përkatësisht bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën, të bëhet në kuadër të marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Sipas Thaçit, Kosova po punon për konsolidimin e rrafshit të jashtëm dhe të brendshëm. "Po

punojmë intensivisht për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Presim me të drejtë në muajt e ardhshëm liberalizimin e vizave. Po punojmë fuqishëm, në koordinim me miqtë tanë, ShBA-në dhe NATO-n, për shndërrimin e Forcës së Sigurisë në Forca të Armatosura të Kosovës, në ushtri të Kosovës. Si dhe në kuadër të dialogut të shtetit të Kosovës dhe Serbisë, do të punojmë në mënyrë unike që të arrijmë marrëveshje paqësore, duke nënkuptuar njohje reciproke, njohje nga pesë vendet e BE-së, anëtarësim në NATO, BE

dhe OKB. Dhe në kuadër të marrëveshjes me Serbinë për korigjimin e kufijve, edhe për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën", ka thënë presidenti Thaçi në ceremoninë e inaugurimit të Kompleksit Memorial të Heronjve dhe Dëshmorëve në fshatin Marinë të Komunës së Skenderajt.

Po në këtë ceremoni kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka deklaruar askush nuk duhet të lejojë që të cenohen sovraniteti dhe integriteti i vendit. Ai ka bërë thirrje për bashkim, duke thënë se Kosova është tokë e shenjtë. "Nuk duhet të lejojmë që të cenohet ky shtet, ky sovranitet, ky integritet. Jemi duke bërë punën më të mirë të mundshme. Ajo çfarë na duhet më shumë është të jemi të bashkuar, mos t'i hapim fjalë njëri-tjetri, për arsyeje se kjo tokë është e shenjtë, sepse edhe amaneti i kolosëve është i shenjtë. Kemi dhënë shumë sakrifica, tash duhet të punojmë edhe më shumë", është shprehur Veseli.

Idea për korigjimin e kufirit është kundërshtuar edhe nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili ka qenë pjesëmarrës në ceremoninë e inaugurimit të Kompleksit Memorial të Heronjve dhe Dëshmorëve në fshatin Marinë të Komunës së Skenderajt. Ai ka thënë se është amanet i dëshmorëve ruajtja e kufijve aktualë të shtetit të Kosovës. "Duhet forcuar shtetin, në ekonomi, politikë të brendshme dhe të jashtme, për të ruajtur Kosovën, për ta ruajtur territorin e vet dhe kufijtë e vet t'i ruajë të paprekshëm prej kurruajt, qoftë ai këtu me ne, qoftë tjetër kund, për shkak se këta kufij na i ka lënë amanet këta që po i rehatojmë. Të gjithë duhet të dinë se rritja jonë na pëlqen të gjithëve, por kurrënjehere nuk guxojmë të lëvizim atë që është mbërritur me gjak", ka deklaruar Haradinaj.

Për procesin e korigjimit të kufirit një ditë më parë ka folur edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen

Bashkurti. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se propozimi për korigjimin e kufirit Kosovë - Serbi është ideja më e komplikuar teorikisht dhe më e vështira për t'u realizuar praktikisht. Sipas Bashkurtit, çdo lëvizje, korigjimi apo shkëmbim territori përmban ndryshim të subjektivitetit politik të popullit që jeton në atë hapësirë. "Nuk është kurrfarë ideje, as origjinale, as e re. Është një ide e vjetër sa vetë shteti. Është ideja më e komplikuar teorikisht dhe më e vështira për t'u realizuar praktikisht. Së pari, territori dhe territorialiteti nuk janë definicione gjeografike, por gjeopolitike. Në shkencat politike thuhet se 'territori është hapësira ose mjedisi ku popujt lindin dhe zhvillojnë identitetet e veta etnokulturore dhe zhvillojnë statuset e tyre ekonomiko-sociale'. Për konsekuencë çdo lëvizje, korigjimi apo shkëmbim territori përmban ndryshim të subjektivitetit politik të popullit që jeton në atë hapësirë", ka deklaruar Bashkurti.

## Nis renovimi i Qendrës Historike në Prishtinë

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka filluar punimet për renovimin e shtëpisë së familjes Safqi në Qendrën Historike afër

Tregut të Gjelbër. "Kanë filluar punimet për renovimin e shtëpisë së familjes Safqi, në Qendrën Historike, afër Tregut të Gjelbër. Kjo shtëpi është në

listën e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore dhe është një nga shtëpitë e rralla tipike të fundshekullit XIX që

ruan një pjesë të tipareve të banimit urban të periudhës otomane", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Flet për "Epokën e re", Ganimete Musliu

# Qeverinë mund ta rrë



Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka thënë se opozita nuk ka asnjë shans ta rrëzojë Qeverinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se paralajmërimet e opozitës për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë janë vetëm përpjekje për ta tërhequr vëmendjen e opinionit publik. Sipas saj, Qeveria Haradinaj mund të shkojë te shtëpia vetëm nëse këtë e duan partnerët e koalicionit qeverisës. Deputetja Musliu ka lavdëruar Qeverinë Haradinaj duke thënë se vetëm për tre muaj ky kabinet qeveritar ka bërë sa Qeveria e kaluar në gjithë mandatin e saj. "Qeverinë mund ta çojë në shtëpi vetëm koalicioni qeverisës, pra pozita. Asnjëherë këtë Qeveri nuk mund ta rrëzojë kjo opozitë", ka thënë Musliu

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 TETOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka mohuar çdo mundësi që Qeverinë aktuale ta rrëzojë opozita. Ajo ka deklaruar se subjektet opozitare nuk i kanë numrat e nevojshme për ta rrëzuar Qeverinë Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Musliu ka

thënë se Qeveria mund të bjerë vetëm nëse dëshirojnë subjektet e koalicionit qeverisës. "Qeverinë mund ta çojë në shtëpi vetëm koalicioni qeverisës, pra pozita. Asnjëherë këtë Qeveri nuk mund ta rrëzojë kjo opozitë. Besoj se për këtë janë të vetëdijshëm opozita dhe opinionit publik. Më vjen keq që opozita me këto pretendime po i manipulon qytetarët e Kosovës. Pra, rrëzimi i Qeverisë ndodh vetëm nëse

ndonjëra prej partive të koalicionit qeverisës merr vendim për këtë çështje, pastaj të bashkëpunojë me partitë opozitare", ka thënë Musliu. Ajo ka deklaruar se paralajmërimet e opozitës se do të ngrehin mocion mosbesimi ndaj Qeverisë janë vetëm përpjekje sa për ta tërhequr vëmendjen e opinionit. "Pyeti secilin deputet të opozitës se si rrëzohet Qeveria, ata do të thonë se për ta arritur këtë qël-

lim duhet t'i kenë 61 vota. Sikur t'i kishin këto vota ata nuk do të kishin nevojë ta rrëzonin Qeverinë, sepse do ta formonin që në fillim të mandatit, për çka edhe kanë tentuar. Kështu që, tani për tani opozita e ka të pamundur ta rrëzojë Qeverinë. Kur e kemi parasysh se ata e dinë që këtë e kanë të pamundur, kjo nismë nuk mund të quhet serioze", është shprehur ajo.

Musliu ka lavdëruar Qeverinë Haradinaj duke thënë se vetëm për tre muaj ky kabinet qeveritar ka bërë sa Qeveria e kaluar në gjithë mandatin e saj. "E kënaqur është fjalë e madhe, mirëpo mund të them se kjo Qeveri është më dinamike dhe më në rrugë të mbarë sesa Qeveria e kaluar, e cila është udhëhequr nga LDK-ja", ka thënë ajo. Sipas Musliut, në këtë performancë të mirë të ekzekutivit po ndikon edhe puna e ministrave të PDK-së. "Sa i përket anës së brendshme

të PDK-së, besoj se tashmë është e qartë edhe për opinionin se PDK-ja nuk ka asnjë luhajtje apo tundime brenda saj. Ajo që dihet është se gjithë ministrat e PDK-së deri më tani kanë treguar një performancë të jashtëzakonshme. Besoj shumë se kjo performancë e mirë e tyre në të mirë të vendit do të vazhdojë deri në fund të mandatit", ka theksuar Musliu.

**"Epoka e re":** Znj. Musliu, liderët e dy partive opozitare kanë paralajmëruar se po bëhen gati për ta rrëzuar Qeverinë me mocion mosbesimi. Cili është komenti juaj për këtë iniciativë?

**Musliu:** Këto përpjekje të tyre kanë për qëllim vetëm për ta tërhequr vëmendjen e opinionit, për çka edhe po ia arrijnë. Tek ne është bërë traditë që të mos shikojmë shumë se kush çka po punon, po kush çka po dëmton më shumë. Në këtë mënyrë, duke paralajmëruar

# zojë vetëm pozita



**"Epoka e re":** Mendoni se ata nuk e kanë seriozisht këtë iniciativë?

**Musliu:** Ata edhe mund ta kenë seriozisht, por e rëndësishme është se opozita ia di hallin vetes dhe është e vetëdijshme se nuk i ka numrat e nevojshëm për ta rrëzuar Qeverinë. Pyeteni secilin deputet të opozitës se si rrëzohet Qeveria dhe ata do të thonë se për ta arritur këtë qëllim duhet t'i kenë 61 vota. Sikur t'i kishin këto vota ata nuk do të kishin nevojë ta rrëzonin Qeverinë, sepse do ta formonin në fillim të mandatit, për çka edhe kanë tentuar. Kështu që, tani për tani opozita e ka të pamundur për ta rrëzuar Qeverinë. Kur e kemi parasysh se ata e dinë që këtë e kanë të pamundur, kjo nismë nuk mund të quhet serioze.

**"Epoka e re":** Pra, nuk i frikësohen një mocioni të tillë?

**Musliu:** Nuk i frikësohem dhe pres rezultat tjetër pos dështimit të kësaj iniciative. Thjesht, në këtë drejtim po përpiqen ta pengojnë punën e Qeverisë dhe ta manipulojnë opinionin publik, por nuk mund të ketë rrëzim të Qeverisë asnjëherë nga kjo opozitë.

**"Epoka e re":** Në fakt, edhe opozita thotë se kjo është një Qeveri që nuk e ka shumicën e mjaftueshme për ta qeverisur vendin.

**Musliu:** Kjo është matematikë. Nëse ata mendojnë se ne nuk e kemi shumicën, atëherë le ta bëjnë ata shumicën dhe ta rrëzojnë Qeverinë. Përderisa ata nuk e kanë shumicën për ta rrëzuar këtë Qeveri, i bie se ne e kemi shumicën për ta vazhduar qeverisjen. Kjo është çështje numrash.

**"Epoka e re":** Në qeverisjen e kaluar opozita edhe më me pak numra kishte iniciuar një mocion, pastaj me përkrahjen e PDK-së e ka rrëzuar Qeverinë. Nëse kemi një mocion mosbesimi nga opozita, mund të presim që ndonjë deputet i PDK-së ta përkrahë këtë mocion?

**Musliu:** PDK-ja është një parti që ka një traditë në organizimin e saj dhe, mbi të gjitha, ka interesin kombëtar. Kjo parti iu përgjigjet situatave të caktuara dhe shpeshherë kur ka qenë në pyetje interesi i Kosovës, ka vendosur në dëm të vetes. Derisa kemi një koalicion qeverisës funksional, personalisht si deputete dhe si anëtare e Kryesisë së PDK-së nuk shoh ndonjë arsye për ta përkrahur një mocion të tillë.

**"Epoka e re":** Kjo i bie se Qeveria mund të rrëzohet vetëm nëse duan partnerët e koalicionit qeverisës me marrëveshje?

**Musliu:** Qeverinë mund ta çojë në shtëpi vetëm koalicioni qeverisës, pra pozita. Asnjëherë këtë Qeveri nuk mund ta rrëzojë kjo opozitë. Besoj se për këtë është e vetëdijshme opozita dhe opinionin publik. Më vjen keq që opozita me këto pretendime po manipulon qytetarët e Kosovës. Pra, rrëzimi i Qeverisë ndodh vetëm nëse ndonjëra prej partive të koalicionit qeverisës merr vendim për këtë çështje, pastaj të bashkëpunojë me partitë opozitare. Mendimi im është se tani zgjedhjet nuk janë zgjidhje, duke pasur parasysh se ato do ta sillnin produktin e njëjtë. E kam thënë më herët, se do të isha për zgjedhje të reja vetëm nëse vendosim që ne 120 deputetët që jemi tani në

Kuvend të mos kandidojmë, në mënyrë që pastaj zgjedhjet të sillnin diçka të re. Përndryshe, pse duhet të shkohet në zgjedhje me njerëz të njëjtë.

**"Epoka e re":** Cili është vlerësimi juaj për Qeverinë Haradinaj?

**Musliu:** Qeveria aktuale përbëhet nga një koalicion i gjerë. Me gjithë respektin që kam për ish-kryeministrin Mustafa, sa ka bërë ai në mandatin e tij, Qeveria Haradinaj ka bërë vetëm brenda tre muajve të mandatit të saj. Kjo Qeveri e ka dinamikën e duhur dhe vullnetin politik për të punuar dhe për t'i çuar proceset përpara. Shpresoj të ecim tutje edhe në proceset e tjera. Siç dihet, u dashtë të vijë kjo Qeveri për ta miratuar demarkacionin me Malin e Zi, sepse Qeveria e kaluar nuk mund ta kalonte ani pse kishim shumë numra. Po ashtu, edhe për projektligjet për transformimin e FSK-së kishim pengesa në atë Qeveri, kurse tani me këtë Qeveri transformimi i FSK-së në ushtri po bëhet realitet. Kam thënë edhe në Kuvend, në fund të mandatit të kaluar, se këtij vendi nuk i duhen liderë që nuk kanë guxim të marrin vendime.

**"Epoka e re":** Domethënë PDK-ja është e kënaqur me këtë qeverisje?

**Musliu:** E kënaqur është fjalë e madhe, mirëpo mund të them se kjo Qeveri është më dinamike dhe më në rrugë të mbarë sesa Qeveria e kaluar, e cila është udhëhequr nga LDK-ja.

**"Epoka e re":** Së fundi kemi parë një ofrim të dorëheqjes

nga një ministër i PDK-së, derisa në medie është raportuar se ka pasur gatishmëri që edhe ministra të tjerë të PDK-së të ofrojnë dorëheqje. A është kaluar kjo situatë në PDK?

**Musliu:** Sa i përket anës së brendshme të PDK-së, besoj se tashmë është e qartë edhe për opinionin, se PDK-ja nuk ka asnjë luhatje apo tundime brenda. Ajo që dihet është se të gjithë ministrat e PDK-së deri më tani kanë treguar performacë të jashtëzakonshme. Besoj shumë se kjo paraqitje e mirë e tyre në të mirë të vendit do të vazhdojë deri në fund të mandatit.

**"Epoka e re":** A është PDK-ja e gatshme për zgjedhje të reja meqenëse, siç dihet, kjo parti është në proces të zgjedhjeve të brendshme?


**Musliu:** PDK-ja është në proces zgjedhor të brendshëm. Siç dihet, me sukses e kemi përfunduar procesin zgjedhor të Rinisë Demokratike të Kosovës, ku ka pasur një garë të hapur dhe transparente, duke angazhuar shumë kadro të reja. Pas këtij procesi të suksesshëm, ne jemi në fazën kur duhet të kemi zgjedhje të brendshme, sepse e kemi mbushur mandatin si struktura. Shpresoj se zgjedhjet e brendshme do të shkojnë në mënyrën e duhur, sepse kemi një organizim adekuat dhe kemi një ekip që është duke punuar fort për mbarëvajtje të këtij procesi. Po ashtu, shpresoj shumë se ky proces do ta nxjerrë edhe më të fuqishme PDK-në. Nëse flasim për zgjedhje të parakohshme, gjë që unë nuk pres se do të ketë, PDK-ja është e gatshme në çdo kohë për këtë proces.

## Qosja: Në bisedimet me Serbinë nuk dilet me deklaratime mohuese ndaj luftës çlirimtare

**PRISHTINË, 5 TETOR (ER)** - Akademik Rexhep Qosja ka komentuar fazën finale të bisedimeve Kosovë - Serbi. Në profilin e vet në "Facebook" Qosja ka porositur për dy gjëra intelektualët shqiptarë. "Në dramën e sotme teatrore e politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit politikanët dhe intelektualët e Kosovës dy gjëra më në fund do të duhej t'i kishin të qarta: E para, mes Prishtinës e Beogradit nuk bëhet dialog: dialogu bëhet mes dy vetëve apo grupeve për punë të ndryshme, kur e kur seri-

oze e kur e kur joserioze. Mes Prishtinës dhe Beogradit ka kohë që po bëhen e do të bëhen bisedime zyrtare, politike dhe diplomatike shtetërore. Vetëm duke i quajtur këto bisedime shtetërore e jo dialog ne e ruajmë dinjitetin shtetëror të Kosovës", ka shkruar Qosja, duke shtuar se në këto bisedime nuk duhet të dilet me deklaratime politike nënshtruese, mohuese ndaj luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "E dyta, në pazarin e sotëm të bisedimeve zyrtare, politike dhe diplomatike

shtetërore në mes të Prishtinës e Beogradit nuk dilet me deklaratime politike nënshtruese, mohuese ndaj luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ishin përmbajtje e mendimeve të kryetarit të LDK-së, Ibrahim Rugova dhe argatit të tij, Nexhat Daci. Historia mund të falsifikohet siç po falsifikohet sot nën dhunën e terrorin politik të oligarkëve politikë e të partive e drejtuesve të tyre, por s'mund të falsifikohet përgjithmonë", ka shkruar akademik Rexhep Qosja.



## Lulzim Tafa dekorohet me Medaljen Presidenciale të Meritave

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Në një pritje ceremoniale në Presidencën e Republikës së Kosovës, krijuesi Lulzim Tafa të premtën është dekoruar me Medaljen Presidenciale të Meritave nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Medalja Presidenciale e Meritave u ndahet personave me kontribut

të veçantë në fusha të veçanta, si në: arsim, shkencë, art, kulturë, rini, sport, shëndetësi e shërbim civil. Presidenti Thaçi në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar: "Me Medaljen Presidenciale të Meritave e dekorova krijuesin letrar Lulzim Tafa për afirmimin e letërsisë shqipe në botë. Çmimi ndërkombëtar 'Mihai Eminescu'

është e arritura më e re e z. Tafa, të cilin e përgëzoja me urimin që të korrë suksese të reja në fushën e letërsisë dhe atë akademike". Lulzim Tafa vazhdon ta japë kontributin e tij në letërsi, duke u shpërblyer me shumë çmime ndërkombëtare e duke qenë një ndër shkrimtarët më të përkthyer shqiptar i letërsisë bashkëkohore.



# Reforma në fushën e inspektimit



PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Të premtën është mbajtur takimi i parë i Komisionit Ekzekutiv për Reformën në Fushën e Inspektimeve. Në takim morën pjesë përfaqësues nga zyra e kryeministrit, MTI-ja, MAP-i, MAPL-ja, projekti i Bankës Botërore i cili e mbështet këtë reformë, përfaqësues të institucioneve të tjera relevante dhe shoqërisë civile.

Në takim janë diskutuar disa çështje me rëndësi e që kanë të bëjnë me statusin aktual të reformës, planin e reformës, listën e

inspektorateve dhe inspektimeve, vizitat në inspektorate, fushëveprimin e reformës, me theks të veçantë kundrejt nivelit lokal dhe institucioneve e agjencive të pavarura.

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se në këtë takim u pajtuan që me rëndësi të madhe në procesin e reformës së fushës së inspektimeve është të analizohet nevoja mbi inspektimet, realisht se për cilat dhe çfarë inspektimesh (në cilat fusha) ka nevojë shteti i Kosovës.

"Kjo na ndihmon për përcaktimin e fushëveprimin të reformës dhe, si rrjedhojë, selektimit të inspektimeve dhe inspektoratëve", ka thënë Tahiri.

Palët pjesëmarrëse në takim u pajtuan për disa veprime si në vijim: Zyra Ligjore, Zyra për Planifikim Strategjik dhe Sekretariat Koordinues të Qeverisë ta njoftojnë komisionin mbi çdo iniciativë të ministrive për themelimin e inspektorateve që mund të ndikojnë procesin e reformës; dhe që Lista e inspektorateve të ndahet me ministrinë

dhe institucionet e tjera relevante në mënyrë që të konfirmohet lista dhe nëse ka eventualisht ndonjë inspektorat apo inspektim shtesë që nuk është në listë. Ndërkaq, në proces më afatgjatë palët u pajtuan që: 1. Projekti i Bankës Botërore, në bashkëpunim me aktorët relevantë, të kryejnë një rishikim funksional dhe organizativ të inspektorateve me qëllim të grupimit të tyre sipas familjeve të inspektorateve apo inspektimeve; 2. Të analizohet se për cilat fusha shteti i Kosovës ka

nevojë për inspektime në mënyrë që më lehtë të përcaktohet fushëveprimi i reformës. Në këtë aspekt, të analizohet me kujdes shtrirja e reformës edhe në nivel lokal dhe në agjenci që janë kushtetues dhe të themeluara nga Kuvendi; 3. Në bazë të dy pikave më lart, të rishikohet lista dhe të vendoset një listë e inspektorateve dhe inspektimeve në Kosovë duke përfshirë grupimin e tyre sipas familjeve për një rishikim funksional sipas grupeve/familjeve dhe mundësive të integritit apo shkrirjes së tyre.

## Molliqaj: Partia Socialdemokrate do të ketë 27 degë deri në dhjetor

Prishtinë, 5 tetor (ER) - Sekretari organizativ i Partisë Socialdemokrate (PSD), Naim Jakaj, dhe anëtari i Kryesisë së kësaj partie, Dardan Molliqaj, u kanë bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen kësaj partie. Duke e njoftuar opinionin publik, përmes një konference për media, lidhur me procesin e shtrirjes dhe zgjerimit të PSD-së, Jakaj ka thënë të premtën se zgjerimi strukturor i projektit socialdemokrat nëpër qytete, fshatra dhe lagje sot është mundësia për ta jetësuar transformimin e Republikës së Kosovës në një shoqëri

demokratike, zhvillimore dhe sociale. Sipas tij, shtrirja organizative do ta bëjë të mundur përhapjen e qëllimeve dhe synimeve politike të Partisë Socialdemokrate në gjithë Republikën e Kosovës.

Duke bërë me dije se Partia Socialdemokrate do t'i hapë gjithsejtë 27 zyra dhe degë në lokalitetet qendrore të Republikës së Kosovës deri në muajin dhjetor të këtij viti, anëtari i Kryesisë, Dardan Molliqaj, ka vlerësuar se PSD-ja është sot përpjekja më e vendosur politike dhe organizata me potencial më të madh progresiv e demokratik, për t'ua kthyer

qytetarëve republikën të cilët janë sot shumica që ka pak dhe që janë të përjashtuar nga kastat e pushtetit. Ai ka thënë se liritë politike e shoqërore në Kosovë duhen të mos mbeten formalitete prej letrë dhe se Republika e Kosovës duhet të çlirohet sa më shpejt nga klientelizmi, krimi dhe korrupsioni, për t'u orientuar njëkohësisht drejt politikave socialdemokrate, të cilat angazhohen edhe për më shumë pavarësi ekonomike dhe barazi sociale, për arsim dhe shëndetësi cilësorë për të gjithë, për mjedis të pastër dhe për pension të dinjitetshëm.



Inaugurohet Kompleksi Memorial i Dëshmorëve dhe Heronjve të Kombit në Marinë të Skenderajt

# UÇK-ja të pamundurën e bëri realitet

Me rastin e inaugurimit të Kompleksit Memorial të Dëshmorëve dhe Heronjve të Kombit, në Marinë të Skenderajt, presidenti Hashim Thaçi ka ndarë urdhrin "Hero i Kosovës" për 158 dëshmorët e varrosur në këtë Kompleks Memorial

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**MARINË/SKENDERAJ, 5 TETOR** - Presidenti Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë në inaugurimin e Kompleksit Memorial të Heronjve dhe Dëshmorëve të Kombit në fshatin Marinë të Komunës së Skenderajt. Po të premtën është bërë rivarrimi i heronjve të kombit Ilaz Kodra, komandant i Brigadës 114 "Fehmi Lladrovci", Mujë Krasniqi, komandant i Brigadës 113 që mban emrin e tij dhe Abedin Rexha, komandant i Brigadës 112 "Arben Haliti". Duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, presidenti Thaçi i ka nderuar me urdhrin më të lartë "Hero i Kosovës" të gjithë dëshmorët e varrosur në Kompleksin Memorial në fshatin Marinë të Skenderajt. Presidenti Thaçi ka thënë se inaugurimi i Kompleksit Memorial të Dëshmorëve dhe Heronjve të Kombit në Marinë po rrumbullakohet me varrimin e mbetjeve mortore të tre komandantëve të lavdishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Abedin Rexhës, Mujë Krasniqit dhe Ilaz Kodrës. "Në këtë tokë të Drenicës do të pushojnë përjetësisht eshtrat e 158 dëshmorëve të UÇK-së. Ata që në kohë dhe vende të ndryshme, në grupe ose individualisht, ranë heroikisht në betejë, istikame, aksione dhe përballje me forcat serbe në vitin 1998 dhe 1999. Këtu do të prehet krenaria e Drenicës, Kosovës

dhe mbarë kombit. Këta emra të skalitur në gurë graniti ishin bijat dhe bijtë tuaj të shtrenjtë. Ishin bashkëluftëtarët tanë që më shumë se jetën e kishin të shtrenjtë lirinë e atdheut, lirinë e Kosovës. Në vitet e papërsëritshme ata u rreshtuan në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", u shpreh presidenti Thaçi. Ai theksoi se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte projekti politik dhe ushtarak më i suksesshëm që ka krijuar historia e qendrës dhe rezistencës së popullit shqiptar. "Këta dëshmorë dhe heronj e mbytën frikën, shpirtin e robit, me armë në dorë, uniformë dhe emblemë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës treguan guximin dhe gatishmërinë për t'iu kundërvënë policisë dhe ushtrisë serbe. Dashuria dhe patriotizmi arritën shkallën më supreme të organizimit përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj UÇK-ja nga strategët



dhe teoricienët e luftës konsiderohet si guerilja më e suksesshme e shekullit njëzet në botë. Ajo doli nga populli. Në të veçori pjesa më e gatshme e kombit për t'u sakrifikuar për çlirimin njëherë e përgjithmonë të Kosovës. Ishte ushtri e vull-

netit dhe gatishmërisë për flajm. Ishte UÇK-ja ajo që e ngriti në pikën më të lartë të ndërkombëtarizimit çështjen e pazgjidhur të Kosovës. UÇK-ja të pamundurën e bëri realitet", ka thënë presidenti Thaçi. Kreu i shtetit shtoi se të rinj dhe të reja, studentë, punëtorë, fermerë, burra dhe gra nga të gjitha trojet kombëtare, me uniformën e UÇK-së ranë në fushën e nderit.

se tre projektligjet që mundësojnë transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të vendit do të vijë brenda disa ditësh ose javësh në Kuvend për votim.

**Haradinaj: Sot po përmbillet borxhi ynë që ua kemi pasur të rënëve për liri**

## Bekim Jashari: Sot Marina po e bart peshën e dhimbjes dhe krenarisë

Ndërkaq kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, duke i falënderuar të gjithë të pranishmit, në veçanti kryeministrin Haradinaj për organizimin, tha se sot Marina hyri në hartën e kombit si vendi ku pushojnë viganët e lirisë dhe nga sot ky vend bëhet pjesë e kujtesës sonë kolektive se si fitohet liria. "Sot Marina po e bart peshën e dhimbjes dhe krenarisë sonë për heronjtë tanë që përjetësisht nga kjo tokë do t'i bëjnë roje atdheut, lirisë sonë, ndërgjegjes sonë", tha kryetari Jashari. Nga një fjalë e kanë mbajtur edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ndërsa në emër të shoqatave të dala nga lufta të pranishmit i ka përshëndetur Hysni Gucati.

**Veseli: Duhet të jemi të bashkuar për ta fuqizuar shtetin e Kosovës**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka deklaruar në Marinë të Skenderajt se toka e Kosovës është e larë me gjakun e dëshmorëve për t'u arritur liria dhe shteti i pavarur e sovran. Në ceremoninë e rivarrimit të dëshmorëve të UÇK-së, Ilaz Kodra, Mujë Krasniqi dhe Abedin Rexha, kryeparlamentari Veseli ka thënë se ëndrra e tyre është frymëzim në rrugën e fuqizimit të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. Veseli ka theksuar se askush nuk duhet të lejojë që të cenohet sovraniteti dhe integriteti i vendit. Ai ka ftuar për bashkim të gjithë ngaqë, sipas tij, Kosova është tokë e shenjtë. "Nuk duhet të lejojmë që të cenohet ky shtet, ky sovranitet, ky integritet. Jemi duke bërë punën më të mirë të mundshme. Ajo çfarë na duhet më shumë është që të jemi të bashkuar, mos t'i hapim fjalë njëri-tjetri, për arsyeje se kjo tokë është e shenjtë, sepse edhe amaneti i kolosëve është i shenjtë, kemi dhënë shumë sakrifica, duhet të punojmë edhe më shumë", ka thënë Veseli. Në këtë ceremoni kryeparlamentari Veseli ka paralajmëruar

"Populli ynë u ka shumë borxh dëshmorëve, por një varr të dinjitetshëm ia kemi borxh çdo qytetari tonë që ka rënë për liri dhe sot po përmbillet një borxh ynë që ua kemi pasur të rënëve për liri", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në inaugurimin e Kompleksit Memorial të dëshmorëve dhe heronjve të kombit në Marinë të Skenderajt.

Para të pranishmëve të shumtë, përfaqësues institucionalë, bashkëluftëtarë, familje të dëshmorëve, kryetari të komunave dhe personalitete të tjera të jetës politike, akademike dhe ushtarake të vendit, kryeministri Haradinaj ka thënë se sot, po zënë vend, në tokën e vet, luftëtarët e kësaj toke, bijtë e këtij populli dhe, të gjithë bashkëluftëtarët e tyre, familjet, ndihen të lehtësuar që më në fund trupat e tyre po prehen në tokën e vet.

Më tutje, kryeministri Haradinaj ka thënë se borxhi tjetër të cilin ua kemi dëshmorëve është se duhet forcuar liria për të cilën ata ranë. "Duhet forcuar shtetin ekonomikisht, politikisht", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se të gjithë duhet të dinë se rritja jonë na pëlqen të gjithëve, por kurrë njëherë nuk bën të lëvizim atë që është mbërritur me gjak.



# Uniteti politik nuk u lihet në dorë të papërgjegjshmëve



Shkruan Jakup  
KRASNIQI

Kur një intelektual i dëgjon politikanët e pozitës dhe të opozitës e kupton se ata nuk e njohin as abc-ën e politikës dhe se ata as që kanë lexuar ndonjë libër shkencor të politikës për çka ekziston një literaturë e begatë politike tek ne. Politika është idealizëm, tek ne ishte një kohë. Politika është konsensus, është

kompromis, është dhe pragmatizëm, tek ne, politika është vetëm interes meskin dhe luftë për pushtet. Këtë të fundit e shohim tek i gjithë spektri politik sot.

Po të ishte politika e organizuar për interesin nacional, ajo në dy çështjet politike të interesit nacional që po diskutohen gjerësisht në medie do të ishte e unifikuar në të dy çështjet: 1. Në çështjen e liberalizimit të vizave, Kosova do të duhej të kishte një zë të unifikuar për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës në zonën shenjen. Pasi edhe kjo pengesë që ka ndodhur deri më sot ka qenë diskriminuese dhe shkelje e rëndë e të drejtave të qytetarëve të Kosovës. Mënyra se si po sillet opozita për këtë

çështje, është më shumë se primitivizëm dhe më shumë se diskriminuese. Të gjithë në Kosovë duhet të flasin me një zë për liberalizimin e vizave. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës duhet të ndodh tani, nesër është vonë. Opozita nuk duhet t'i gëzohet shtyrjes së liberalizimit të vizave ajo duhet t'i ofroj 101 arsyeje pse qytetarët e Kosovës është dashur edhe deri më tani ta kishin këtë të drejtë edhe për faktin se në gjithë vendet e Evropës Juglindore është shteti me numër më të vogël të popullsisë. 2. Pozitë dhe opozitë duhet të formojnë grupin për bisedime dhe strategjinë e çështjeve që duhet të bisedohen për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë.

Konsensusi për këtë çështje është i domosdoshëm që të ndodh, më mirë sot se nesër. Kushdo që të jetë në pushtet, sot apo nesër, konsensusi do të jetë i domosdoshëm. Konsensusi duhet të arrihet në Kuvendin e Kosovës nga GP shqiptare. Nuk është mirë që të humbim shumë kohë për këtë çështje, pasi konsensusi është i domosdoshëm të arrihet, ndonëse normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë nuk varet nga ne, por kjo është tjetër çështje. Çështje që nuk duhet të na vejë në siklet me kohën. Koha e normalizimit të marrëdhënieve nuk duhet të jetë qëllimi, qëllimi është përmbajtja dhe cilësia e marrëveshjes për

normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Çdo ngutje është për...! Diçka si mënyra e debatit që po zhvillohet për korrigjimin e kufijve a shkëmbimin e territoreve?! Debat që edhe mënyrën e komunikimit nder partiake e ka bërë tërëz.


Të përfundojmë, ne si komb, si politikë e njerëz, në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë që të papërgjegjshmit, në cilindo nivel të pushtetit që janë, të na jenë mostër për veprimet politike të çakorduara siç janë momentalisht. Përkundrazi, të papërgjegjshmit vetëm konsensusi nacional i nxjerr jashtë ndikimeve politike që janë në interes të vendit e të kombit. Këto çështje kërkojnë qasje serioze nga politika përfaqësuese!

## Reformat e Ministrisë së Financave po japin efekt në zhvillimin ekonomik të vendit

### Growth in the region strengthened in 2018, driven by public investment

Kosovo: Good growth performance is expected to continue through 2018 with a projected 4.2 percent, supported by public investment, service exports and consumption

Real GDP growth, percent



Source: World Bank staff calculations based on data from national statistical offices. Note Kosovo 2018 data based on SAK recent revision.

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - Reformat e ndërmarra gjatë vitit të fundit nga Ministria e Financave, për ta ndihmuar zhvillimin e sektorit privat, përveçse po vlerësohen nga biznesi, po vlerësohen lart edhe në raportet e Bankës Botërore. Raporti i fundit i Bankës Botërore për rajonin e Ballkanit Perëndimor vlerëson se ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2018 pritet të shënojë një rritje reale prej 4.2 përqindësh, duke vazhduar të renditet si vendi me rritjen më të shpejtë ekonomike në rajon. "Kjo perspektivë pozitive e ekonomisë së Kosovës, gjithnjë sipas raportit të Bankës

Botërore, i atribuohet rritjes së investimeve totale dhe performancës më të mirë të eksporteve si rrjedhojë e pritjeve optimiste në ekonominë e Eurozonës dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Gjithashtu, vazhdimi i përmirësimit të kapaciteteve absorbuese të investimeve nga institucionet financiare ndërkombëtare do të jetë një shtytës tjetër pozitiv për përshpejtimin e rritjes ekonomike në Kosovë", është theksuar në komunikatën e Ministrisë së Financave.

Sipas MF-së, ngjashëm me vitin 2018, rritja ekonomike do të vazhdojë të përshpejtohet edhe në horizontin afatmesëm (2019-2020), duke u luhatur

rreth nivelit 4.5 për qind, ndërkohë që deficitit buxhetor, sipas raportit të BB-së, do të vazhdojë ta respektojë rregullën fiskale gjatë periudhës së parashikuar. "Për të ardhur deri tek ky rezultat shumë pozitiv i rritjes ekonomike të Kosovës, e që është edhe prirës në rajon, Ministria e Financave ka ndërmarrë një mori veprimesh që nga dita e parë e marrjes së mandatit të ministrit Bedri Hamza. Ndër veprimet kryesore përfshihen edhe ndryshimet e politikave fiskale, themelimi dhe zhvillimi i instrumenteve të ndryshme financiare për mbështetje të biznesit, si dhe shumë veprime të tjera ligjore dhe operative, me qëllim të zhvillimit të sek-

torit privat", është bërë me dije në komunikatën për media. Ministria e Financave ka theksuar në komunikatë se Kosova, përveçse ka arritur ta ketë rritjen më të madhe të zhvillimit në rajon, kjo pa dyshim se do të ndikojë edhe në motivimin e investitorëve të rinj për investime në Kosovë. "Ministria e Financave nuk do të ndalet me kaq. Ne do t'i vazhdojmë edhe reformat e tjera tani të bëra publike për vitin e ardhshëm, ku në këtë Raport të Bankës Botërore theksohet rëndësia e vazhdimin të procesit të reformave në ekonomi, duke u mbështetur edhe në planifikimet buxhetore", është thënë në komunikatën për media. Me këtë rast, Ministria e

Financave thekson se këto pritje të Bankës Botërore janë në linjë edhe me të dhënat më të fundit zyrtare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për vitin 2017, sipas së cilës, ekonomia e Kosovës për vitin 2017 u rrit me 4.23 për qind, në terma realë, e nxitur kryesisht nga investimet dhe konsumi. "Gjithashtu, të dhënat e përditësuara për gjysmën e parë të vitit 2018 nga ASK-ja konfirmojnë vazhdimin e ecurisë pozitive të ekonomisë gjatë këtij viti. Edhe komuniteti i biznesit në të gjitha anketat ka dëshmuar se bizneset janë shumë të kënaqura me politikën fiskale në përgjithësi", është thënë në komunikatën e Ministrisë së Financave.



## Në Pestovë të Vushtrrisë shënohet "Dita e patates"

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Bizneset prodhuese dhe përpunuese do të mbështeten edhe më shumë me grante, subvencione dhe me politika fiskale në mënyrë që të kenë më shumë prodhim për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Kështu ka thënë të premten kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në manifestimin "Dita e patates" që është mbajtur në Pestovë të Vushtrrisë.

Para fermerëve dhe përpunuesve të patates, Veseli ka theksuar se Kosova është vend i njerëzve punëtorë dhe i mundësive të mëdha në ekonomi. "Patriotë bashkëkohorë janë prodhuesit, punëtorët e vyer të Kosovës, ata që me punën e tyre, me iniciativat e tyre ekonomike hapin vende të reja të punës", është shprehur ai, duke shtuar se vizioni në dekadën e dytë të pavarë-

sisë është që Kosova të prodhojë dhe eksportojë sa më shumë produkte. "Qeveria e Kosovës i ka të qarta obligimet: të sigurojë mbështetje të plotë për bizneset vendore, t'i përkrahë jo vetëm me subvencione, por edhe me lehtësirat fiskale dhe me masa të tjera, që prodhimet e Kosovës të mund të depërtojnë në tregjet ndërkombëtare", ka deklaruar Veseli.



# Lekaj zotohet për përmbushjen e rekomandimeve nga auditorët

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, gjatë raportimit të tij para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka bërë me dije se nuk është i kënaqur me gjendjen e menaxhimit që ka gjetur në këtë ministri, por ka dhënë premtime se do të punohet për përmbushjen e rekomandimeve të dala nga auditorët



bëtare. Ndërsa deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka përmendur disa nga problemet të cilat janë gjetur në raportin e auditorit. "Një problem tjetër është mungesa e sistemimit dhe ruajtjes së rregullt të dokumentacionit. Te pagat dhe menaxhimi i personelit, auditori vëren mbajtjen e personelit me ushtrues të detyrës. Problemi tjetër të prokurimi është klasifikimi i shpenzimeve kapitale dhe pasqyrat financiare nuk paraqiten drejt. Ka keqklasifikime të mallrat, kurse të menaxhimi i borxheve del se ato janë rritur gjatë vitit 2017", ka thënë Hoti, duke shtuar se rekomandimet e vitit paraprak janë zbatuar në masë të kënaqshme.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Driton Selmanaj, ka folur për punësimin e qytetarit serb i cili nuk e ushtron detyrën në këtë ministri. Ai ka thënë se duhet të dinë se çfarë pune kryejnë këta njerëz. "Nuk mund të paguhet dhe të mos punojnë. Kjo është e jashtëligjshme dhe nuk thuhet kështu në marrëveshje ndërkombëtare", ka deklaruar ai.

EPOKA ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar të premten raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës. Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, gjatë raportimit para anëtarëve të këtij komisioni, ka bërë me dije se nuk është i kënaqur me gjendjen e menaxhimit që ka gjetur në këtë ministri. Ai ka premtuar se do të punohet për përmbushjen e rekomandimeve të dala nga auditorët. "Nuk jam i kënaqur me menaxhimin që kam gjetur në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Janë diku 18 çështje të theksuara për menaxhimin e financave publike duke u bazuar në prioritetet, por edhe

në vijat buxhetore. Pas marrjes së raportit të auditimit në muajin qershor, nuk kemi pasur një argument të fuqishëm t'i kundërshtojmë këto të gjetura. Ka ardhur një auditim përfundimtar me çështje të kualifikuara me argumente jo fort të pranueshme. Pas kësaj, kemi bërë planin e veprimit për përmbushjen e raportit të auditimit dhe do të përpiqemi që t'i përmbushim këto kritere", ka deklaruar Lekaj. Ministri Lekaj ka sqaruar të dhënat e auditorit, duke thënë se si ministri janë duke iu përmbajtur vijave buxhetore. Ai ka përmendur edhe punësimin e një zyrtari serb që paguhet nga Ministria e Infrastrukturës, por që nuk e ushtron detyrën e tij, por që ka ardhur në këtë pozitë përmes një marrëveshje ndërkomb-


## Kosova bëhet me tregues gjeografik

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Kosova tashmë ka Treguesin Gjeografik që është nënshkruar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. Udhëzimi Administrativ, për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografikë, Emërtimit të Origjinës dhe Specialitetet Tradicionale të Garantuara rregullon formën, përmbajtjen dhe përdorimin e simboleve apo shenjave të treguesit gjeografik. Çdo produkt me prejardhje nga Kosova që tregtohet në bazë të emërtimit të origjinës, treguesi gjeografik duhet të etiketohet me shenjën apo simbolin përkatës "Tregues Gjeografik i Mbrojtur"

dhe "Emërtimi i Origjinës i Mbrojtur", apo simbole që shoqërojnë ato. Ministri Shala ka thënë se ky Udhëzim Administrativ do t'u ndihmojë shumë prodhuesve vendorë dhe do t'i fuqizojë produktet e Kosovës. "Me këtë udhëzim administrativ mundësohet regjistrimi dhe mbrojtja e produkteve me tregues gjeografikë, emërtimet e origjinës dhe specialitetet tradicionale të garantuara. Kjo do të ndikojë në fuqizimin e produkteve vendore që i ka Kosova, sepse produktet e regjistruara dhe të mbrojtura nga MTI-ja do

të identifikohen me shenjën e Republikës së Kosovës", ka thënë Shala.

Udhëzimi Administrativ shpjegon edhe mënyrën e përdorimit të shenjave të treguesit gjeografik. "Agjencia për Pronësi Industriale në mënyrë elektronike u ofron simbolin apo shenjën e treguesit gjeografik, emërtimit të origjinës dhe specialitetit tradicional të garantuar, prodhuesit, përpunuesit apo përdoruesit për shënjimin dhe reklamimin e produktit", thuhet në Udhëzimin Administrativ që është nënshkruar nga ministri Shala.



## Dogana për nëntë muaj mblodhi 837 milionë euro

PRISHTINË, 5 TETOR - Gjatë periudhës nëntëmuajore (janar - shtator 2018) të hyrat e përgjithshme të inkasuara nga Dogana e Kosovës në total arritën vlerën rreth 837 milionë euro që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, paraqet rritje prej 3.13 përqindësh apo rreth 25.5 milionë euro më shumë. Sipas një njoftimi nga Dogana, ndikim në të hyrat e grumbulluara nga Dogana gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe MSA-ja,

pakoja fiskale që i referohet lirimeve nga taksat në import për prodhuesit si dhe importi i veturave të përdorura. "Sa i përket lirimeve, sipas MSA-së, duhet theksuar se ndikimi në të hyra nga MSA-ja përgjatë kësaj periudhe është rreth 33 milionë euro, ndërsa ndikimi në të hyra i pakos fiskale që i referohen prodhuesve përgjatë periudhës raportuese është rreth 56 milionë euro", është thënë në njoftimin e Doganës.



## UNDP-ja dhuron pajisje për Policinë e Kosovës

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) përmes Projektit për Siguri në Kosovë (KSSP) të premtën i ka dorëzuar pajisje teknike shtesë Policisë së Kosovës (PK). Me këtë rast Policia e Kosovës, përkatësisht Pika Referuese për Armë të Zjarrit (FFP), ka përfutur gjashtë laptopë, dy tableta dhe pajisje mbështetëse. Këto pajisje do t'i rrisin kapacitetet e FFP-së, veçanërisht Njësisë për Bashkëpunim dhe Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit (ILECU), sektor ky që lufton trafikimin e paligjshëm

të armëve. "Pika Referuese për Armë të Zjarrit (FFP) është e para e këtij lloji në Ballkanin Perëndimor dhe tani po përdoret si praktikë më e mirë për juridiksionet fqinje për vendosjen e pikave të tyre referuese, duke e bërë Kosovën eksportuese të sigurisë. Përveç kësaj, sipas Planit të Veprimit të Evropës Juglindore, Pika Referuese e Armëve të Zjarrit është një domosdoshmëri në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve", është thënë në komunikatën e UNDP-së. Drejtori i Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës,

Riza Shillova, dhe përfaqësuesit e UNDP-së, Marta K. Gazideda, manaxhere e Portofolit për Qeverisje dhe Ndërtim të Paqes dhe zëvendëskoordinatorë e Programit dhe Alain Lapon, menaxher i Projektit të KSSP-së, kanë deklaruar që ky partneritet do ta mbështesë më tej zhvillimin e politikave dhe teknikave të gjurmimit, duke përforcuar nivelin e hetimit të krimeve me armë në Kosovë. Këto pajisje teknike i ka mundësuar kontributi financiar nga Fondi i Mirëbesimit i OKB-së për Mbështetjen e Bashkëpunimit për Sistemimin e Armëve (UNSCAR).

## Ruqiqi dhe Ahmeti pajtohen për trajtimin e problemeve të bizneseve që veprojnë në Prishtinë

PRISHTINË, 5 TETOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Ruqiqi, ka pritur në takim të premtën kryetarin e Komunitetit të Prishtinës, Shpend Ahmeti. Ata njëzëri u pajtuan që të krijojnë një trup të përgjithshme e cila do të merret me trajtimin e problemeve të bizneseve që veprojnë në kryeqytet. Kjo marrëveshje u arrit përmes një memorandumit të bashkëpunimit, i cili u nënshkrua nga kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Ruqiqi dhe kryetari i Komunitetit të Prishtinës, Shpend Ahmeti. Ahmeti ka deklaruar se përmes kësaj marrëveshje kompanitë që veprojnë në Prishtinë do ta kenë më lehtë t'i adresojnë problemet e tyre. "Probleme të njëjta ngrehin disa kompani dhe kjo nënkupton se nuk kemi nevojë për zgjidhje individuale. Kemi dy sektorë që më së



shumti kemi komunikim: sektori i ndërtimit, ku vazhdimisht kompanitë kërkojnë leje, lehtësim të procedurave; dhe sektori i gastronomisë, për shkak të numrit të madh të restoranteve dhe kafiterive. Në këtë drejtim kemi vendosur ta nënshkruajmë një memorandum bashkëpunimi, me ç'rast do të kemi një trup të përhershme jo vetëm kur ka çështje, por në vazhdimësi të komu-

nikojmë. Ideja e këtij bashkëpunimi është të pajtohemi sa më shumë që është e mundur dhe t'i adresojmë çështjet", është shprehur Ahmeti. Ndërkaq, kryetari i OEK-ut, Berat Ruqiqi, ka thënë se një marrëveshje e tillë, përveç zgjidhjes së problemeve të bizneseve, do të ndikojë për zhvillimin e tyre dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

## Rahoveci furnizohet me vaksina kundër gripit sezonal për të moshuar

RAHOVEC, 5 TETOR (ER) - Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, Samir Mustafa, ka njoftuar se janë furnizuar me vaksina kundër gripit sezonal për të moshuar. Ai ka bërë me dije se vaksinat janë pa pagesë dhe do të vaksinohen të gjithë personat e moshuar dhe me sëmundje kronike. "Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Fahredin Hoti' në Rahovec është

furnizuar me vaksina kundër gripit sezonal nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës dhe vaksinat janë pa pagesë. Në ditët në vazhdim do të fillohet vaksinimi i të gjithë atyre të cilët kanë nevojë për vaksinim në QKMF dhe në QME, në gjithë territorin komunës. Nëse ka nevojë, vaksinat mund t'i shpërndajmë edhe në qendra të tjera të mjekësisë familjare", ka thënë drejtori Mustafa..



# Putini është njeri i mirë, Pacolli është edhe më i mirë!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Kosova, eldorado për matrapazë dhe për çdo gjë 99 centë:** Nuk ka vend më të fortë se Kosova në rajon, por edhe më gjerë, në çdo aspekt. Nuk mbeti kush pa e ndukur, pa e plaçkitur, pa e dhunuar, pa e shfrytëzuar, pa e keqpërdorur, që nga "miqtë" ndërkombëtarë, një pjesë e të cilëve janë, ose hajna ordinerë, ose plaçkitës të sofistikuar e deri te vendorët që e filluan si hajna të pulave, për të përfunduar si "biznesmenë" në Dubai, Turqi, Kinë, Serbi, Rusi, Kazakistan, Kurcistan, Kroaci e deri te shtetet evropiane dhe në ShBA. Janë bërë mjeshtër për pastrim parash duke investuar në pika të karburanteve, ndërtime të larta, përfaqësues të kompanive fitimprurëse, kryesisht për anëtarë të familjes së ngushtë, kontrollojnë laboratorët për cilësinë e karburanteve dhe vajrave si dhe importimin e tyre, importin e duhanit, kafesë, pijeve alkoolike, gjësendeve luksoze, makinave të kushtueshme, një pjesë të tregut medial, lojërave të fatit, procesin e privatizimit, investimet në shëndetësinë private, arsimin e mesëm dhe të lartë privat, dhënien e tenderëve duke filluar nga 10 000 euro e deri në shumë dhjetëra e qindra milionë euro. Kemi pasurim të hatashëm të familjeve të caktuara e që më parë e kishin statusin social sikur që kemi raste kur edhe shoqëruarit apo truprojat e politikanëve janë bërë milionerë dhe investitorë të suksesshëm. Kemi turqizim të bizneseve, sistemit bankar, sistemit shëndetësor, të aseteve kryesore dhe më fitimprurëse të Kosovës, që nga infrastruktura rrugore dhe ajrore deri te sistemi i telekomunikimit dhe atij energjetik. Përkundër kësaj, Kosova e ka infrastrukturën rrugore më të mirë në rajon dhe ka potencial të madh zhvillimor e që po e ngufatë politika dhe hajdutët që janë pasuruar në emër dhe me ndihmën e politikës duke bërë përpjekje të shndërron në oligarkë. Oligarkia e ka burimin në ish-Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e regjimit komunist në Ballkan, sikur edhe në Kinë, për faktin se, përmes oligarkëve, politikanët i pas-tronin paratë e vjedhura sikur

që edhe e shtrinin ndikimin politik përmes miliarda e miliarda dollarë dhe euro të plaçkitura nga populli. Oligarkizmin dhe oligarkët më të fuqishëm ishin në Rusi dhe Kinë ku shteti i krijoi miliardet brenda natës dhe të cilët, me ato para të pista depërtuan në të gjitha fushat e investimeve ku më lehtë pastroheshin paratë dhe më lehtë ktheheshin te pronari i cili në të vërtetë ishte kryeoligarku e që mbante pozitën numër 1 të pushtetit. Në Kosovë nuk kishte oligarkë të emancipuar dhe të ditur, por ishin analfabetë të veshur me kostumin e oligarkut e që nuk iu shkante kurrsesi. Në Kosovë si oligarkë të improvizuar mund të llogariten Ekrem Lluka, Ramiz Kelmendi, Vëllazëria Devolli, Latif Kryeziu dhe disa shpageti oligarkë. Realisht, nëse dikush mund ta mbajë barrën e një oligarku potencial, që nga burimi e deri te kohët e sotme, ai është Behgjet Pacolli dhe asnjëri tjetër. Më herët Pacolli ka bërë biznes, që nga Jelcini e deri te despotët e Kazakistanit për ta zgjeruar perandorinë edhe në disa shtete me një demokraci diktatoriale, tash e ka për zemër Rexhep Tajip Erdoganin dhe Hashim Haxhi Thaçin. Është një tip i oligarkëve që mjaftohen të shërbejnë si lavatriçe për politikanët dhe nuk kanë ambicie politike sepse edhe vetë pasurohen, dhe këta jetojnë gjatë ose, po aq gjatë sa jeton sponsori i tyre apo ata që e trashëgojnë. Ata që duan të ngritën mbi Zeusin (Zotin e të gjithë zotave) e që duan pushtet politik, kryesisht e kanë fundin tragjik. Rastin më të mirë për ta dëshmuar këtë e keni me disa oligarkë rusë që, ose përfundojnë në burgje, ose si viktima në një rën nga metropolet evropiane. Apo rasti i vëllezërve Kariq që nga muzikantë, politika e Serbisë i shndërroi në oligarkë, kurse kariqët bën përpjekje të klonojnë oligarkë në mesin e biznesmenëve kosovarë. Kur ambiciet e tyre dolën mbi mandatin e pastruesve të parave për Millosheviqin dhe të tjerët, ua prenë kokat politike duke i detyruar të shkojnë në vendin e origjinës së oligarkëve, Rusinë e Jelcinit dhe të Putinit. Në Kosovë asnjë oligarkuci nuk i ka munguar një qime nga koka (ata që i kanë pasur) sepse kanë qëndruar larg politikës, por qençe i kanë shërbyer politikës. I vetmi oligarkuc që e provoi fatin në politikë ishte Ramiz Kelmendi dhe i cili asnjëherë nuk u bë politikan, por u shndërrua në kondom që e provuan të gjithë udhëheqësit e subjekteve krye-

sore politike në Kosovë. Behgjet Pacolli është oligark burimor i stepeve ruse dhe të Kaukazit. Historia e tij është e shkruar, e përfolur, e keqkuptuar, e shkruar drejt, varësisht nga këndi i interesit, në favor të përkrahjes së tij (kur ua ka trashur lëngun) apo me qëllim të diskreditimit të tij, kryesisht për shkaqe biznesi. Begja është i rryer dhe dinak, si të ishte binjak siamez me Hashimin me të cilën edhe lidhi kokë e këmbë tash e sa kohë. Për vite të tëra u ndoq nga Karla del Ponte së cilës, në fund, në dosjen e saj i mbetëm koq... e Begjës për faktin se autoritetet ruse ishin në anën e Begjës dhe me Begjën. Behgjet Pacolli, si patriot i dëshmuar ndër shekuj, u kthye në Kosovë për t'i ndihmuar popullit të shumëvujtur dhe shumë të dashur kosovarë duke ua ndërtuar në qendër të Prishtinës hotelin "Swiss Diamond", vend tipik për skamnorë dhe ata që janë të varfër... në tru. Ky është vendtakim, vendpushim dhe vendrelaksim për Hashimin dhe kotillën e tij politike. Begja është humanist dhe me shpirt të madh, ka ndodhur që edhe brekët e veta ia ka dhënë tjetrit për t'u larë në pishinën e këtij hoteli për të pastrehët dhe varfanjakët mendorë të politikës dhe inteligjencës së Kosovës. Begja, si shok i ngushtë i Trampit, nga një oligark i importuar nga Kaukazi, u shndërrua në politikan, jashtëzakonisht të fuqishëm dhe me ndikim, sidomos në skenën ndërkombëtare, e në veçanti në Burkina Faso, Ganë, Somali, Sudan dhe shtetet e tjera me një demokraci shembullore. Te politikanët e tjerë, këshilltarët janë më të mençur se shefi i tyre sikur që, p. sh., Hashimi është më i mençur se Bekimi, Smajli, Ragip leshi dhe të tjerët, kurse Begja është shumë më i mençur se, p. sh., Mentor Nazarko për faktin se i flet shtatë gjuhë, përfshirë këtu edhe gjuhën shqipe të cilën më mirë e flet sesa që e shkruan. Në mesin e gjuhëve të huaja pra, Begja e flet edhe gjuhën shqipe, variantin kosovar me theks nga Lugina e Marecit. Në rrafshin shqiptar, si njohës dhe folës i gjuhëve të huaja, me Begjën mund të krahasohen vetëm Fan Stilian Noli dhe Neritan Ceka, kurse në rrafshin kosovar Begjës ia kalon vetëm i ndjeri deputet Haxhi Merxha që i ka folur, sipas tij, nëntë gjuhë të huaja, kurse i ka kuptuar vetëm tri: gjuhën rome, serbe dhe kokni albanian. Begja e flet shkëlqyeshëm gjuhën ruse, serbe, italiane,

angleze, urdu të Pakistanit, Swahili dhe e kupton pjesërisht gjuhën shqipe. Nejse, nga politika ruse u bë oligark dhe nga pseudopolitika e Kosovës po përpiqet të bëhet politikan. Nga mbështetja pa rezervë e partive të krahut të luftës dhe me mbështetjen logjistike të disa komandantëve të luftës u bë president i Kosovës dhe komandant i forcave të paarmatosura dhe paramilitare të Kosovës. Gjithashtu, pati përkrahje të pazervë të një diplomati dhe ambasadori zhvatës siç ishte Delli dhe një Pushikari, kondom i Dellit dhe vetë Begjës. Nuk pati jetë të gjatë si "president", por se jetën tash po ia zgjatë ortaku i tij dhe i Erdoganit, Hashimi, që ia ka vendosur fotografinë në mesin e atyre që ishin presidentë, fiktivë, historikë, të zarfit, që e shkelën Kushtetutën etj. e që nuk ka pasur të drejtë sepse Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk e ka njohur Behgjet Pacollin si president, kurse Hashimi si Gjykatë Kushtetuese mbi gjykatën Kushtetuese e ngjalli mumien e presidentit për çka herët a vonë do të japë përgjegjësi, në mesin e shumë përgjegjësive që i ka. Pastaj, erdhi një kohë e vegetimit politik për Begjën për ta rikthyer në skenën politike disa titistë të SPS apo një pjesë e LDK-së sikur edhe disa veteranë - politikanë mashtrues të krahut të luftës. Tash oligarku i Kaukazit dhe pseudopolitikan Pacolli i ka dy poste të larta, ministër për Punë të Jashtme për çështje të biznesit personal dhe z/kryeministër i parë (i dyti është Enver Hoxhaj dhe Dardan Gashi), për të pasur leje që të marrë pjesë në mbledhjet e qeverisë. Behgjet Pacolli në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kishte kapacitetin diplomatik të një bariu nga Gjylekara. Kah ka shkuar nëpër godinën e Kombeve të Bashkuara e ka bërë m.t. në vend se për këtë ta përdorë vendin e paraparë për këtë, avdes-hanen apo WC e Kombeve të Bashkuara. Jo që nuk pati asnjë pasojë për këtë prostitucion diplomatik që e bëri në Kombe të Bashkuara ku u dhunua politikisht dhe me fakte nga të gjithë ata me të cilët u takua, në veçanti me Ana Bërnabiqin, kryeministër e Serbisë e cila luajti fort koq... me Begjën e Hashimit sikur edhe nga të gjithë të tjerët, por vazhdoi për Portugalin për të siguruar njohje nga ky shtet dhe i cili na ka njohur ndër të parët. Pastaj, për ta vazhduar diplomacinë e kanalizimit e dha një intervistë ku tha se midis Kosovës dhe

Serbisë nuk duhet të ketë kufij gjë që në vazhdimësi po e thonë Vuçiqi, Vulini, Gjuriqi dhe Daçiqi. Dhe krejt në fund, për ta fituar titullin e Kalorësit të Nderit të Prostitucionit Diplomatik, deklaroi se Vladimir Putini është një njeri i mirë sikur që edhe Vuçiqi në Ujman tha se Millosheviqi kishte plane të mira, por jo edhe ekzekutim të mirë! Ndoshta Behgjet Pacolli di diçka më tepër për Putinin kur deklaroi se është njeri i mirë e që ne shqiptarët nuk e dimë, në veçanti unë si injorant që jam, nuk kam informata për mirësinë dhe humanizmin e Vladimir Putinit që po e ditka Begja! E tash, ky me ta udhëheqë Ministrinë për Punë të Jashtme dhe përfaqëson Kosovën! A ka më tmerr dhe më keq?! Lexues të nderuar, këta që po e përkrahin Behgjet Pacollin me të gjitha këto që po i bënë, në një kohë dhe një vakt e patën eliminuar kandidaturën e Bacës Adem Demaçi për president të Kosovës, të përbashkuar me IV të asaj kohe sikur që pjesa e SPS (Socialistika Partija Serbije) e një segmenti të LDK-së (Lidhja Demokratike e Kosovës) sot po e refuzon emërtimin e një rruge në Fushë-Kosovë me emrin e Bacës Adem Demaçi! Sikur që komandantët e LDK-së, pa komandantin kryesor Isa Mustafa dhe me komisarët politikë, komandant Dullën dhe komisarët Haxhi Avdyli, Driton Selmanaj, Lum Pusi si dhe krahu ushtarak me trashëgimtarët e kolonelit të KOS-it, e bojkotuan varrimin dhe të pamet për Bacën Adem në kohën kur zgërdheshin para Teatrit Kombëtar ku priste radhë e gjatë për të pame për Simbolin dhe Kuptimin e Lirisë së Shqiptarëve dhe të gjithë Popujve të Robëruar, Bacë Adem Demaçi. Në të njëjtën kohë jam kundër asaj që disa të dështuar në PDK dhe përfitues ordinerë të manipulojnë me emrin e Bacës Adem Demaçi duke bërë përpjekje të përfitojnë politikisht, aq më parë që Baca Adem Demaçi nuk ka qenë i asnjë partie dhe ka qenë mbi të gjitha partitë, si vlerë universale. Prandaj, është e papranueshme përpjekja e disa mashtruesve në PDK që ta luftojnë LDK-në apo një parti tjetër duke e keqpërdorur emrin e Adem Demaçit! Sikur edhe e atyre që bëjnë, kinse tryeza apo filma plehër dokumentarë për ta përkujtuar emrin dhe veprën e Adem Demaçit. Baca Adem Demaçi, si monument njerëzor dhe kombëtar, duhet të ketë përkujdesje institucionale dhe shtetërore, nga Shqipëria në radhë të parë, pastaj edhe nga Kosova. Asgjë tjetër!

## Ish-presidenti i Koresë Jugore dënohet me 15 vjet burgim



Seul, 5 korrik - Ish-presidenti i Koresë Jugore, Lee Myung-bak, është dënuar me 15 burgim për korrupsion. Lee është ndëshkuar në një seancë në Seul të premten nën akuzat për ryshfet, përvetësim dhe abuzim me pushtetin, duke u udhruar që të paguajë edhe 11.5 milionë dollarë gjobë. Ish-presidenti në anën tjetër ka pretenduar se akuzat janë të motivuara politikisht. Ai është bërë

ish-lideri i katërt jugkorean që është burgosur, duke pasuar burgimin e paraardhësit të tij në muajin prill.

Park Geun-hye është dënuar me 33 vjet burgim pasi është gjetur fajtor për abuzim me pushtetin. Lee nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore për shkak të, siç është thënë, shëndetit të dobët. Ndërkohë Gjykata në Seul ka thënë se "ndëshkimi i ashpër për

të akuzuarin ka qenë i pashmangshëm" për shkak të natyrës serioze të krimit.

Gjykata ka gjetur se ish-lideri ka pranuar të holla në vlera miliardëshe nga kompania Samsung, në këmbim të faljes së udhëheqësit të kësaj ndërmarrjeje, Lee Kun-hee.

Megjithatë kompania ka mohuar se i ka dhënë ish-presidentit të holla.

## Kavanaugh edhe një hap më afër pozitës në Gjykatën Supreme

I nominuari i presidentit Trump, Brett Kavanaugh, për gjykatës në Gjykatën Supreme të ShBA-së është votuar të premten në Senat dhe vëmendja ka kaluar te katër senatorë, në votimin përfundimtar që zhvillohet sot (e shtunë). Votimi i tij ka pasuar protestat kundër Kavanaugh, pasi qindra persona janë arrestuar teksa kanë kundërshtuar nominimin e tij në Uashington



Uashington, 5 tetor - Senati amerikan ka votuar në të mirë të Brett Kavanaugh, të nominuarit të presidentit amerikan Donald Trump, për gjykatës në Gjykatën Supreme, duke dërguar një hap më tej procesin e miratimit të tij. Ky votim është konsideruar test për mbështetjen që ka Kavanaugh, i cili është përballur me akuzat për sjellje të keqe seksuale nga disa gra. Tani vëmendja ka kaluar te katër senatorë, në votimin përfundimtar që zhvillohet sot (e shtunë).

Në votimin procedural, 51 sen-

atorë kanë votuar për dhe 49 kundër gjyqtarit Kavanaugh. Miratimi i Kavanaugh të shtunën në Senat do ta kthente gjykatën më të lartë në Shtetet e Bashkuara në favor të konservatorëve në vitet e ardhshme. Paneli prej nëntë gjyqtarëve në Gjykatën Supreme e ka fjalën e fundit në çështje të rëndësishme në ShBA, përfshirë abortin, kontrollin e armëve dhe aspekte të tjera në jetën politike. Përveç të tjerash, mandati i tyre është i përvetshëm. Votimi i së premtes ka pasuar protestat kundër Kavanaugh,

pasi qindra persona janë arrestuar teksa kanë kundërshtuar nominimin e tij në Uashington.

Mijëra protestues, kryesisht gra, marshuan në Uashington, duke nisur nga Gjykata e Apelit, ku Kavanaugh kryeson aktualisht. Policia ndërhyri pasi protestuesit u ulën pranë një zyre të Senatit dhe refuzuan të lëvizin. Një protestë tjetër u zhvillua edhe para Kullës Trump në Nju Jork.

Protestat janë mbajtur në ditën kur FBI-ja ka dërguar në Komitetin Gjyqësor të Senatit,

raportin për Kavanaugh rreth pretendimeve kundër tij për sjellje të keqe seksuale. Demokratët kanë thënë se hetimet e kësaj agjencie janë

zhvilluar në një rreth më të ngushtë sesa që është kërkuar derisa republikanët kanë thënë se ai nuk vërteton akuzat kundër Kavanaugh.

## Zhduket shefi i Interpolit, Franca nis hetimet



PARIS, 5 TETOR - Autoritetet franceze kanë nisur hetime, meqë presidenti i Agjencisë së Policisë Ndërkombëtare, INTERPOL, Meng Hongwei, është raportuar i zhdukur, pasi ka udhëtuar në shtetin e tij të origjinës, Kinë. Gruja e Hongwei ka kontaktuar policinë në Lion, qytetin francez ku ka selinë kjo agjenci, pasi burri i saj nuk është lajmëruar prej kur ka arritur në Kinë më 29 shtator, kanë thënë burime nga policia dhe gjyqësori.

INTERPOL-i ende nuk ka komentuar asgjë rreth këtij rasti. Funkcioni kyç i kësaj agjencie është të ofrojë mekanizma për forcat policore në vende të ndryshme, ashtu që ato të ndryshme, ashtu që ato të njoftojnë njëra-tjetrën për të dyshuarit e kërkuar. Meng, 64-vjeçar, është emëruar president i INTERPOL-it më 2016, pasi ka mbajtur një varg pozitash të larta në Kinë, duke përfshirë pozitën e zëvendës-ministrit.

Mandati i tij në agjencinë ndërkombëtare është deri më 2020.

Vëzhguesit e të drejtave të njeriut kanë shprehur shqetësimin e tyre se Kina mund ta përdorë pozitën e Mengit për t'i ndjekur disidentët jashtë shtetit. Kina ka tentuar disa herë të kërkojë ndihmë nga shtetet e huaja për t'i arrestuar dhe deportuar qytetarët kinezë që akuzohen në vendin e tyre për krime përfshirë korrupsionin dhe terrorizmin.

## Gjykata e Apelit i konfirmon dy vjet burgim Nikolla Gruevskit

Shkup, 5 tetor - Gjykata e Apelit në Shkup ka fuqizuar vendimin e Gjykatës Themelore për dënimin me ish-kryeministrit të Maqedonisë, Nikolla Gruevski, me dy vjet burgim.

Gruevski është shpallur fajtor për rastin "Tanku" që ka të bëjë me keqpërdorimet për blerjen e një makine të llojit Mercedes për afër

600 mijë euro.


Për të njëjtën vepër me 4 vjet e gjysmë burgim është dënuar edhe ndihmës-ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski ndërsa një proces i veçantë po zhvillohet edhe ndaj ish-ministres, Gordana Jankulovska.

Në vitin 2011 MPB-ja kishte vendosur të blejë një makinë të blinduar

deri me 243 mijë euro. Por, me insistim të ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, ministrja Jankulovska kishte nënshkruar vendimin për blerjen e një makine tjetër, të pajisur sipas shijeve të Gruevskit, vlera e së cilës kishte arritur në mbi gjysmë milioni euro.

Shpërdorimet janë zbuluar nga afëra e përgjimeve telefonike të pub-

likuar nga LSDM-ja e cila atë kohë ishte në opozitë. Procesin gjyqësor e ka udhëhequr Prokuroria Speciale, e formuar për hetimin e shpërdorimit të detyrës së qeverisë së kaluar. Nikolla Gruevski ka drejtuar Qeverinë e Maqedonisë për 10 vjet, sikur edhe partinë opozitare VMRO-DPMNE. Gruevski e ka cilësuar procesin të "montuar".



# NJË SKËNDERBE NDRYSHE NË NJË ALBUM TË HUAJ

(Eqrem Zenelaj, "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në veprat e artistëve evropianë", Prishtinë, 2018)

**Mirsad R. DAKAJ**

Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ky hero kombëtar shqiptar, jeta dhe vepra e të cilit tejkalojnë përmasat vetëm të një figurë kombëtare, është veçuar dhe vazhdon të veçohet, të çmohet dhe të bëhet objekt studimi edhe nga shumë të huaj.

Skënderbeu, përveçse ishte strateg ushtarak, ishte dhe i zgjuar, poliglot, diplomat dhe burrështetas. Mbi të gjitha, ishte edhe mbrojtës i civilizimit evropian. Kësaj na paraqitet "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në veprat e artistëve evropianë" në librin e profesor Eqrem Zenelajt botuar këtë vit, me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, Skënderbeut.

Për veprimtarinë e heronjve kombëtarë, edhe të atyre me përmasa botërore që lënë gjurmë të pashlyeshme në histori, sado që të shkruajmë, jeta dhe veprimtaria e tyre është e vështirë të përmblihet në faqe libri, sepse nuk mund të përshkruhet të gjitha hollësitë nga jeta e tyre. Për të tilla personalitete, sikur për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, është shkruar dhe do të shkruhet edhe në të ardhmen, sikurse ka shkruar dhe përgatitur albumin e tij historik, doktori dhe profesori i shkencës juridike, Eqrem Zenelaj, i cili sjellë për lexuesit jo vetëm të historisë, shumë fakte për etnogjenezën e jetën e këtij personi famëmadh.

Albumi i Eqrem Zenelajt, në të cilin janë përmbledhur portrete, gravurat, harta dhe fotografi (të cilat janë të shoqëruara me shpjegim në gjuhën shqipe dhe angleze), nga autorë të njohur dhe të panjohur, jo vetëm të heroit kombëtar shqiptar - Gjergj Kastrioti Skënderbeu, por edhe të familjes së tij, është rezultat i një pune të pandërprerë hulumtuuese 20-vjeçare. Autori gjatë kësaj periudhe ka hulumtuar nëpër arkivat më të njohura dhe më të vjetra të Evropës, si: në Londër, Frankfurt, Vjenë, Lajpcig, Nurnberg, Padovë, Napoli, Romë, Raguzë (Dubrovnik), Budapest etj.

Profesor Zenelaj albumin e vet për heroin kombëtar, Skënderbeun, e fillon me një paraqitje historike për të. I pasuruar me dokumente arkivore, autori dëshmon etnogjenezën dhe pemën gjenealogjike të kulluar shqiptare të familjes Kastrioti, e cila në fillim bartte mbiemrin Mazreku e më vonë Kastrioti, e që rridhte nga fshati Mazrek i Hasit.

Profesor Zenelaj jep shembuj e dëshmi të kronikave të huaja dhe të autorëve të mesjetës, si Giacomo di Pietro Lvccari, Fallmerayeri, Frang Bardhi, Charles Du Frense Du Cang, Eugen Barbarich etj., mbi gjenealogjinë e vërtetë të familjes Kastrioti. Pra, në mënyrë të argumentuar e shkencore u jep fund manipulimeve sllave me historinë e kësaj familje, që kanë tentuar e tentojnë ta paraqesin si familje me prejardhje serbo-sllave. Autori, duke u bazuar në referenca nga autorë të ndryshëm dhe duke analizuar kohen kur Skënderbeu u mor peng në Stamboll, sjell fakte bindëse e të argumentuara në mënyrë të shkëlqyer mbi datën e saktë të lindjes dhe vdekjes së tij.

Në këtë terren autori sjell rrefime, dëshmi, fakte dhe të dhëna e referenca të ndryshme që kanë të bëjnë me atdheun e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, me familjen



Eqrem M. Zenelaj

**ALBUM HISTORIK KOMBËTAR  
NATIONAL HISTORICAL ALBUM**

(ME RASTIN E 550-VJETORIT TË VDEKJES SË  
HEROIT KOMBËTAR SHQIPTAR)  
(ON THE OCCASION OF MARKING THE 550th  
ANNIVERSARY OF THE DEATH OF THE  
ALBANIAN NATIONAL HERO)

GJERGJ KASTRIOTI-GIORGIO KASTRIOTA  
**SKËNDERBEU**  
SCANDERBEG

(në veprat e artistëve evropianë dhe burime të vjetra arkivore)  
(in the works of European artists and old archival sources)

Kastrioti, me Shqipërinë, gjë që, në këtë kontekst, ky studim është një "informacion" jashtëzakonisht i dobishëm për të pasur mundësi për absorbimin njohës, të gjithanshëm të figurës së Skënderbeut. Në këtë aspekt, etnogjeneza, historia, identiteti etj., që kanë ndikuar në formësimin dhe edukimin atdhetar të njeriut, në këtë rast të Skënderbeut.

Ai pasqyron, zbërthen dhe argumenton marrjen peng të Skënderbeut nga osmanët në moshën nëntëvjeçare, pajtimin mes tyre dhe babait të tij, Gjonit, që Gjergj Kastrioti të bëhej princ i Shqipërisë, e tradhtinë e osmanëve ndaj tij. Argumenton sukseset e tij në ushtrinë osmane, dashurinë mes tij dhe sulltaneshës Servilia, në fund edhe kthimin e tij në Krujë, ku më vonë u shpall Dominus Albaniae (Zot i Shqipërisë). Të gjitha këto janë paraqitur edhe nëpërmjet portreteve dhe janë shp-

jeguar qartë dhe thjesht.

Duke e cilësuar figurën e Skënderbeut si një patriot e diplomat, autori Eqrem Zenelaj në këtë libër me vlerë shkencore nuk shpërfaq vetëm aspektin e etnogjenezës dhe të veprimtarisë dhe filozofisë atdhetare të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, por studimin e tij të kësaj figure e bazon edhe te dimensionet e personalitetit, tipologjisë, karakterit dhe të vetive e pasioneve të ndryshme jetësore.

Albumi i profesor Eqrem Zenelajt përmban edhe shumë gravura të vendeve të ndryshme, franceze, italiane, portugeze etj., portrete në luftime e takime, në Kuvendin e Lezhës të vitit 1444, por edhe fotografi të qytetit të Krujës në vitet e hershme të shekullit të kaluar. Po ashtu, pasqyron edhe flamurin e stemën e familjes Kastrioti dhe harta të vjetra të Shqipërisë.

Krejt në fund, autori tregon për jetën e Skënderbeut "në shtratin e vdekjes" dhe vdekjen e tij të dyshimtë dhe mundësinë e helmimit nga venedikasin.


Albumi i profesor Zenelajt për Skënderbeun informon saktë, kryesisht nga dokumentet arkivore, për këtë personalitet të madh të Evropës në shek. XV e që, për shkak të interesimit që ngjallë personazhi te lexuesit shqiptarë dhe të huaj, përveç në gjuhën shqipe, është i përkthyer edhe në gjuhën angleze.

Derisa i referohemi studimit, strukturës, mënyrës së shkrimit, metodologjive, shembujve dhe referencave të shumta, teorive si dhe bibliografisë së zgjedhur me shumë përkushtim, s'ka dyshim se edhe ne si lexues apo si analizues të tekstit, të z. Zenelaj, nuk mund t'u shmangemi një morie të dhënash dhe faktesh të banueshme, që i japin tekstit kuptim dhe besueshmëri.

E rrallë

## Vajza tetëvjeçare zbulon shpatën 1500-vjeçare në liqenin suedez

Një vajzë tetëvjeçare në Suedi ka gjetur gjatë verës së këtij viti një shpatë të vikingëve që llogaritet të jetë e vjetër 1500 vjeç. Saga Vanecek ka qenë duke i larguar mënjanë



gurët në një liqen në Suedinë jugore, kur ka hasur në një shpatë e cila ndodhej në baltë, ka treguar babai i vajzës, Andy Vanecek, nëpërmjet një shkrimi në "Facebook".

FOTO E DITES




Festimi i Festivalit të Dritave është një konkurs Ndërkombëtar i Fishekjarrëve që zhvillohet çdo vit në Vancouver, British Columbia. / Nacional Geographic/

E jashtëzakonshme

## Adoleshenti indonezian mbijeton 49 ditë në det në 'kasolle peshkimi'

Një adoleshent indonezian, i cili kujdesej për një kasolle peshkimi, mbijetoi për 49 ditë në det, duke gatuar peshk mbi dru të marrë nga anija e tij. Aldi Novel Adilang ishte në kasolle



125 kilometra larg bregut indonezian kur erërat e rënda i detyruan anijet e tij të parakohshme, duke hedhur 18-vjeçarin. Ai përfundoi mijëra kilometra larg pranë Guamit, ku ai u kap nga një anije panameze.

## BARSOLETA E DITËS



- Eh more Beni, duhet të zgjohesh më herët. Shih, komshiu ynë, Ganiu, u zgjua herët dhe në rrugë i gjeti 300 euro, - i thotë nëna djalit.  
- Po, por ai që i ka humbur është zgjuar edhe më herët!




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### “ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### “JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### “NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### “SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### “VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Nëse jeni marrë me aktivitete sportive sot


do të ndieni të gjitha pasojat e mira për fizikun tuaj. Do të rikuperoni një marrëdhënie të ndërprerë.



**DEMI**

Keni mjaft luhatje humori dhe nuk

ndiheni të stabilizuar në ambientin e punës. Ndryshime të mëdha priten të ndodhin gjatë ditës.



**BINJAKËT**

Optimizmi që ju karakterizon ju jep

shumë shpresë për të ardhmen. Megjithëse ndodheni në fund të tunelit do të arrini ta gjeni dritën.



**GAFORRJA**

Mos u tërhiqni nga objektivat

tuaja megjithëse rruga për t'i arritur mund t'ju duket e gjatë dhe e vështirë. Çdo gjë do të zgjidhet mirë.



**LUANI**

Dinamizmi që ju karakterizon sot ka

mënyra të ndryshme për t'u shprehur. Do të jeni pikë referimi për shumë persona të afërt.



**IRGJËRESHA**

Sot mund të hidhni hapa të gabuar

duke u shtyrë nga instinkti dhe jo nga logjika. Do të ketë pasoja të pariparueshme për ju në të ardhmen.



**PESHORJA**

Gjëra pozitive parashikohen sot për ju

dhe ndiheni të rrethuar nga miq të mirë dhe të sinqertë. Edhe pse një fjalë e tyre do t'ju bezdisë s'do të reagoni.



**AKREPI**

Çdo gjë që ju lidh me një person të

caktuar sot po vihet në dyshim nga disa fjalë që ju kanë prekur dhe që janë thënë për ju.



**SHIGJETARI**

Sot mund t'ju prishet disi qetësia

dhe do t'ju duhet të ndërhyni në një situatë të tensionuar që vetëm ju mund ta zgjidhni.



**BRICJAPI**

Jeni të hapur ndaj çdo sfide ose

njohje të re. Keni filluar ta ndryshoni mënyrën tuaj të të menduarit sa iu përket shumë situatave.



**UJORI**

Ruani qetësinë në disa situata të

komplikuara që do të verifikohen sot përgjatë ditës. E rëndësishme është që në fund ju dini çfarë doni.



**PESHQIT**

Kohë ndryshimesh për ju. Do të

filloni diçka të re që ka zënë gjithë ditën dhe kohën tuaj. Jeni mjaft kurioz se çfarë do të ndodhë.

# "TY TA FALIM JETËN E NA DUKET PAK...!"



**Fetnete RAMOSAJ**

Njëzet vjet pas përfundimit të luftës, që dikush po përpiqet ta mohojë dhe ta harrojë, shteti ynë ende nuk ka arritur t'ua rregullojë varrezat, pa i përmendur të zhdukurit, që nuk kanë as shenjë as varr! Pas vendimit të Kryeministrit Haradinaj, të datës 8 maj 2018, i cili emëroi Komisionin përkatës, në krye me ministrin e FSK-së, Rrustem Berisha, për zhvarrimet dhe rivarrimet e dëshmorëve, që nga 19 qershori i këtij viti deri më 31 korrik ditë për ditë Ushtria e Kosovës bëri zhvarrime e rivarrime dëshmorësh të UÇK-së të Zonës Operative të Drenicës. Të gjithë këta dëshmorë të kombit, u rivarrosën me nderime të larta ushtarake të Gardës Ceremoniale të Ushtrisë së Kosovës.

Siç u bë e ditur, vetëm nga varrezat e Polacit u zhvarrosën 112 dëshmorë, prej tyre 101 u rivarrosën në Kompleksin Memorial në Marinë, e të tjerët në Vushtrri dy, në Landovicë dy, në Kleçkë një, në Shtime pesë dhe në Ferizaj një. Edhe 53 dëshmorë të tjerë u zhvarrosën nga komunat e Drenasit e Skenderajt dhe u rivarrosën në Marinë. Ndërkaq sot, në ditën kur po përurohet Kompleksi Memorial në Marinë, po rivarrosen heronjtë Mujë Krasniqi-Kapuçi, Iljaz Kodra dhe Abedin Rexha. Të gjithë këta dëshmorë për dy dekada pas përfundimit të luftës ishin në

varre jo të denja për ta, të parregulluara, pa emra mbi varre, apo me varre të rrafshuara ashtu siç ishin varrosur në rrethana të luftës apo të pasluftës.

E mbani mend se si gjatë gjithë kësaj kohe, më shumë se një pjesë e njerëzve që me vetëdije a pa të, në formë histerie janë vënë në garë për ta njoollur e përdhosur çdo vlerë të luftës për liri dhe të sakrificave të paçmueshme të këtij populli të shumëvujtur, duke i mohuar sakrificat e tyre, qielli i gjithëpushtetshëm shfaq shumë më shumë dhembje e krenari për dëshmorët e atdheut! Për dy muaj me radhë, ndonëse stina e verës, ditë për ditë herë binte shi, herë shndrisnin rrezet e diellit, duke u bashkuar me dhimbjen dhe krenarinë e familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe atdhetarëve të vetëdijshëm për sakrificat e jashtëzakonshme!

E mbani mend se si gjatë të njëjtës periudhë, na u rishfaqën në medie fondet e luftës, përdorimi apo keqpërdorimi i tyre. Nuk bëhet fjalë për shuma të vogla, por për shuma marramendëse që nga dy e katër milionë marka gjermane, deri në 250 milionë, 400 milionë apo deri në mbi 900 milionë marka, duke hedhur dyshime se përveç tjerash, një pjesë e tyre kanë përfunduar edhe në anë të tjera ku nuk është dashur! Për këto flitej e shkruhej me aq lehtësi, sikur të mos bëhej fjalë për miliona, por sikur për para xhepi, pa dhënë askush llogari as përgjegjësi për to deri më sot. Sa djemtë na u vranë në pritë e ushtrisë jugosllave-serbe, duke i kaluar kufijtë ndërshqiptarë për të siguruar armatim! Sa djemtë mbetën me nga tri javë të flenë në shi e në të ftohtë, ku për shtrojë kishin tokën e për mbulojë qiellin, duke

pritur armatim në veriun e Shqipërisë, e sa shumë prej tyre u detyruan të kthehen duarthatë, duke kaluar nëpër rreziqe të shumëfishta... Sikur këto mjete që përmenden e që ishin të dedikuara për luftën, të ishin përdorur si duhet, e të shkonin në destinacionin e caktuar, sigurisht se do të kishim më pak humbje në njerëz e luftën do ta kishim më të lehtë!

E mbani mend se si një fushatë e tërë gjatë kësaj kohe u zhvillua dhe po vazhdon të zhvillohet kundër veteranëve të luftës, se si e paskan keqpërdorur dhe dëmtuar rëndë buxhetin e shtetit, me nga 170 euro! Kjo shumë nuk do duhej të ishte pension i luftëtarit! Ky nuk është pension, është mëshirë! Shihni se si i trajtojnë shtetet e popujt e tjerë veteranët e luftës. Aq shumë ekzagjerime, përgjithësime, poshtërime e padrejtësi ndaj tyre tash e njëzet vjet. Të diskriminuar në punësim, shumë prej tyre të sëmurë, të varfër, pa kullm mbi kokë... Në emër të "rrejshmërisë", Prokuroria Speciale e Kosovës, mbi 20 mijë vetëve ua publikoi kundërligjshëm të dhënat personale në medie (shumë prej tyre luftëtarë të shquar të UÇK-së), duke e shkelur rëndë ligjin dhe duke e rrezikuar sigurinë e tyre dhe të tjerëve, gjë që nuk ka guxuar të ndodhë qofshin të rrejshëm apo të pa rrejshëm! Pse ndodhi kjo?! Qysh kur vendimet e Prokurorisë janë të plotfuqishme pa vendim gjykatë?! Mbase edhe për të arsytuar faktin se shumë nga dosjet e veteranëve të luftës, invalidëve dhe kategorive të tjera të lirisë, mund të kenë përfunduar të duart e Serbisë, të cilat po i përdorë për nevoja të saj. Ç'është gjithë kjo fushatë denigruese e ky

ekzagjerim i çështjes së veteranëve?! Nëse u dashka të gjykohej, pse po u bëhet gjyqi në medie e jo në gjykatë?! Pse edhe pas njëzet vjetësh po tentohet të kryqëzohet UÇK-ja?! Nëse Prokuroria jonë nuk ka ditur si të veprojë me rastin e veteranëve, ka mundur ta marrë për bazë shembullin e Kroacisë. Me të gjitha çështjet që po përballlemi ne, Kroacia është përballur para nesh. Në Kroaci, që nga viti 1995, ende ka raste të vërtetimit të rasteve të veteranëve apo invalidëve të rrejshëm, të cilët pas njëzet vjetësh, me vendim gjykatë, janë detyruar t'ia kthejnë shtetit mjetet materiale të përvetësuara e të shfrytëzuara pa meritë.

Shpresojmë se ata që e përfaqësojnë shtetin, në të gjitha segmentet, në këtë rast në organet e drejtësisë, të jenë të vetëdijshëm, të dinë ku janë, nuk janë në vitet 1981-1989 kur i dënuan e ndëshkuan padrejtësisht dhjetëra mijëra studentë për pjesëmarrje në demonstrata, nuk janë duke punuar në masat e dhunshme në administratën pushtuese serbe nën drejtimin e kryekriminelit të Ballkanit, Slobodan Millosheviq, por në shtetin e lirë e demokratik të Kosovës!

Kenë vënë re se si në njërin anë zhvillohet fushatë për t'i akuzuar kategoritë e lirisë se po e "hanë" buxhetin e shtetit të Kosovës?! Kjo është bërë temë dite, temë jave, temë muaji, temë viti... Por, në anën tjetër, shumë veteranë e invalidë të luftës, si dhe familje të dëshmorëve po i mbushin ekranet televizive si kategoria sociale e njerëzve më të varfër të vendit. Kenë parë se si vetëm pas njëzet vjetësh, falë njerëzve të vullnetit të mirë, u bënë me

shtëpi dy fëmijët jetimë të familjes Nebihu nga Qirezi, Valoni e Valentina, të cilëve forcat serbe ua vranë para syve të dy prindërit, dhe familjarët e tjerë më 28 shkurt 1998, në shtëpinë e tyre. Nëna e tyre, Rukija, ishte shtatzënë në muajin e shtatë! Keni parë gëzimin e veteranit të luftës në Vushtrri, i cili gëzimin më të madh në jetë, para kamerave, tha se e kishte pas arriti të hapte një bunar për ujë në oborr! Edhe kjo falë njerëzve të vullnetit të mirë...

Sot në këtë ditë tetori, sikur të ishte ditë pranvere, u përrua Kompleksi Memorial në Marinë të Skenderajt dhe me nderime të larta u rivarrosën edhe kolosët e UÇK-së, Mujë Krasniqi, Iljaz Kodra e Abedin Rexha, përkrah 158 dëshmorëve-heronj të UÇK-së! Ata që luftonin e këndonin. Ata që besonin në forcën e fitores së lirisë edhe në ditën më të vështirë! Ata që i këndonin Kosovës së larë me gjakun e bijve e bijave më të mira të këtij vendi, "Ty ta falim jetën e na duket pak!", u kthen edhe vet në këngë. Është fat i madh të japësh jetën për Liri!

Për veten time, jam shumë e nderuar dhe krenare që isha pjesë e luftës për liri, e njerëzve të terrenit, që mbi gjithçka e kishim lirinë! Ashtu janë dhe duhet të jetë të gjithë bashkëluftëtarët e mi, pavarësisht sfidave të kohës! Jo gjithkush e ka fatin të jetë pjesë e bërjes së Lirisë!

Mirënjohje dhe respekt kryeministrit Haradinaj, kryetarit të Skenderajt Bekim Jashari, Ushtrisë së Kosovës dhe të gjithë të tjerëve që e përmbushën këtë obligim njerëzor e shtetëror, duke bënë të mundur pas njëzet vjetësh prehjen e përvetshme të këtyre dëshmorëve në tokën e shenjtë të Kosovës!



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BIRMINGHAM - ROTHERHAM

1

KAIZER CHIEFS - POLOKWANE

1

BLACKPOOL - ROCHDALE

1

# Shillova synon epitelin e golashënuesit dhe kreun me Flamurtarin

Alban Shillova synon të shpallet golashënuesi më i mirë në IPKO Superligë. Ai po kërkon edhe rezultate sa më pozitive me skuadrën e Flamurtarit nga Prishtina. "Jam mjaft i kënaqur për formën individuale dhe të ekipit të Flamurtarit. Kryesore për mua janë sukseset e skuadrës. Jam i përgatitur mirë fizikisht dhe do të shënoj shumë gola. Mbase do të jem i pari në listën e golashënuesve", ka thënë Alban Shillova

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 5 tetor** - Nuk është vetëm skuadra e Flamurtarit befasia në këtë edicion në futbollin e Kosovës. Befasi tjetër është edhe sulmuesi Alban Shillova, i cili është pjesë e skuadrës kuqezi. Shillova në tetë xhirot e para ka shkëlqyer në IPKO Superligë, duke shënuar shtatë gola. Pa dyshim se është më meritori për rezultatet e klubit kryeqytetas në Superligë.

Të premtën për "Epokën e re" Alban Shillova ka thënë se është i kënaqur me atë që ka ofruar deri tash në elitë, kurse premtën se do të vazhdojë me këtë ritëm edhe në ndeshjet e radhës. "Jam mjaft i kënaqur për formën individuale dhe të ekipit të Flamurtarit. Kryesore për mua janë sukseset e skuadrës. Jam i përgatitur mirë fizikisht dhe do të shënoj shumë gola. Mbase do të jem i pari në listën e golashënuesve", ka thënë Shillova, i cili ka shprehur optimizëm se edhe skuadra e Flamurtarit do të vazhdojë të shfaqë lojërë të mira dhe të marrë rezultate pozitive në xhirot e radhës. "Besoj se Flamurtari ka qenë befasi e mirë e këtij kampionati dhe në vazhdimësi ka treguar se është në gjendje të tregojë lojërë të mira dhe të marrë rezultate të favorshme. Atmosfera është e mirë në klub dhe besoj se rezultatet nuk do të mungo-

jnë", ka shtuar ai.

Në kuadër të xhiros së nëntë në elitë, Flamurtari të dielën do të luajë ndaj Trepçës '89 në stadiumin "Riza Lusha" në Mitrovicë. Lidhur me këtë ndeshje sulmuesi Shillova ka deklaruar: "Në ndeshjen e radhës do të shkojmë pa presion dhe shpresoj të marrim rezultat pozitiv". Aktualisht Flamurtari pozicionohet në pozitën e tretë në renditjen tabelore me 15 pikë, duke regjistruar katër fitore, tri barazime dhe një humbje.

## Sot zhvillohet derbi Prishtina - Llapi

Sot (e shtunë) zhvillohen katër ndeshje të javës së nëntë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja derbi zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në mes të Prishtinës dhe Llapit, skuadra të cilat synim kanë titullin e kampionës në këtë edicion. Skuadra e Prishtinës në ndeshjen e fundit iu kthye fitoreve në Prizren, pasi e mposhti Lirinë me rezultat 0-1, kurse Llapi, edhe pse me një lojtar me shumë në pjesën e dytë, pësoi humbje nga Feronikeli në ndeshjen e zhvilluar në Podujevë (0-1). Skuadra lidere e elitës, Feronikeli, ka punë më të lehtë në këtë xhiro, pasi e pret në Drenas skuadrën e fundit në tabelë. Dy ndeshjet e tjera që zhvillohen të shtunën janë

Ballkani - Ferizaj dhe Drenica - Drita. Të dielën zhvillohen dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro, kurse takohen Gjilani - Liria dhe Trepça '89 - Flamurtari.

## IPKO Superliga

Të shtunën takohen:  
15:00 Ballkani - Ferizaj  
15:00 Feronikeli - KEK-u  
15:00 Drenica - Drita  
17:45 Prishtina - Llapi

Të dielën takohen:  
15:00 Gjilani - Liria  
15:00 Trepça '89 - Flamurtari

## LIGA E PARË

Të shtunën takohen:  
Fushë Kosova - Bashkimi K  
Dukagjini - Vitia  
Onixi - Kika

Të dielën takohen:  
Drenasi - Trepça  
Vushtrria - Istogu  
Vëllaznimi - Arbëria  
2 Korriku - Besa

Të hënën takohen:  
Ramiz Sadiku - Vllaznia  
(Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 15:00)

## SHKURT

### Dënohen Rexha, Tovërlani dhe tri klube të Superligës

Futbollisti i Feronikelit, Kastriot Rexha, është dënuar me dy ndeshje moslojë nga Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës. Ky dënim për sulmuesin erdhi për shkak të incidentit që ai kishte me futbollistin Behar Maliqi në ndeshjen e mesjavës Llapi - Feronikeli. Ndërsa trajneri i Ferizajt, Afrim Tovërlani, është dënuar me 15 euro, pasi ka bërë shkelje të kodit të etikës sportive. Komisioni i FFK-së dënoi edhe tri klube elitare: Gjilani, Dritën dhe Prishtinën me nga 1 000 euro. Gjilani dhe Drita u dënuan për hedhje të gjësendeve në terren, kurse Prishtina për shkak se tifozët e saj e ofenduan trajnerin Mirel Josa.

### Greзда lavdëron Gerradin

Futbollisti shqiptar Eros Grezda e ka lavdëruar trajnerin e vet të ri në skuadrën e Rangersit, Stiven Gerrad. "Trajneri është shumë profesionist. Ai ka një veti dhe arrin të krijojë një atmosferë shumë të mirë gjatë stërvitjes. Është i qetë dhe përgatitjet dhe stërvitjet janë shumë të mira. Kam me të vërtetë vetëm fjalë të mira për të dhe nuk di nëse ka ndonjë mangësi", ka thënë Grezda.

### Messi shpallet Lojtar i Javës për herë të dytë me radhë në "Champions"

Lionel Messi është shpallur Lojtar i Javës edhe për ndeshjet e dyta të fazës grupore në Ligën e Kampionëve. Argjentinasi mori këtë çmim pasi realizoi dy gola kundër Tottenhamit në fitoren 4 me 2. 32-vjeçari ishte më i votuari në garën me Paulo Dybalan, Neymarin dhe Edin Xhekon. Messi ishte shpallur Lojtar i Javës në Ligën e Kampionëve edhe në ndeshjen e parë të grupeve kur realizoi tre gola ndaj PSV-së. Argjentinasi ishte më i votuari nga tre pretendentët e tjerë: James Millner, Nabil Fekir dhe Paul Pogba.

### Mercedesi, tepër i shpejtë. Vetteli "dorëzohet" para garës në Suzuka

Pas provave të lira në pistën e Suzukës, duket se në kampin e Ferrarit do ta pranojnë një gjysmë dështimi në garën e Japonisë, në Formulën 1. Edhe pse u rezervua në parashikimin e ndalesës aziatike këtë diel, piloti gjerman Sebastian Vettel pranoi se rivalët e "kokëkuqes" janë të shpejtë. "Jam i kënaqur nga paraqitja e makinës, pasi ishte një ditë e qetë në krahasim me garat e tjera. Gjithsesi nuk jemi shumë të shpejtë dhe do të duhet të punojmë shumë që ta japim maksimumin në provat kualifikuese. Nëse Mercedesi do të jetë kaq i shpejtë sa këtë të premte, do të jetë e vështirë për 'pole position'-in", ka thënë Sebastian Vetteli.

Jo shumë i kënaqur është dukur protagonist i tjetër i Ferrarit, finlandezi Kimi Raikkonen. "Vuajta si gjithmonë për ta mbajtur ritmin dhe për ta regjistruar kohën më të ulët, por kemi shumë punë për të bërë. Nuk e di nëse shiu mund të na ndihmojë në provat zyrtare, por do të shohim çfarë na rezervojnë retë", ka deklaruar Raikkonen.



## Challandesi publikon listën e futbollistëve

Prishtinë, 5 tetor - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, e ka bërë publike sot listën e futbollistëve të cilët do t'i ketë në dispozicion për ndeshjet kundër Maltës, më 11 tetor, në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe më

14 tetor kundër Ishujve Faroe si mysafirë në kuadër të Ligës së Kombeve.

Grumbullimi i futbollistëve bëhet të hënën më 8 tetor, derisa stërvitja e parë zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën

18:00.

Lista e futbollistëve: Samir Ujkani, Faton Maloku, Visar Bekaj, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Mërgim Vojvoda, Ardin Dallku, Leart Paçarada, Benjamin Kololli, Valon Berisha,

Hekuran Kryeziu, Herolind Shala, Idriz Voca, Besar Halimi, Bernard Berisha, Arbër Zeneli, Milot Rashica, Edon Zhegrova, Donis Avdijaj, Elbasan Rashani, Vedat Muriqi, Atdhe Nuhiu, Lirim Kastrati.



## Dy derbi në basketboll



PRISHTINË, 5 TETOR - Xhiroja e tretë në Superligën e Kosovës në basketboll karakterizohet me dy derbi. Të shtunën në Suharekë, me fillim nga ora 19:00, Golden Eagle Ylli e pret Rahovecin, ndeshje kjo që pritet të sjellë rivalitet të madh, por edhe basketboll cilësor. Ndërkaq të dielën në program është një tjetër duel shumë interesant, ku takohen rivalët lokalë, Bashkimi dhe Ponte Prizreni. Kjo ndeshje do të luhet me fillim nga ora 17:00 në palestrën e sportit "Sezai Surroi" në Prizren. Dy takimet e tjera që do të luhen në kuadër të kësaj xhiroje janë Lipjani-Trepça që do të

zhvillohet të shtunën në palestrën e sportit "Bill Klinton" në Ferizaj me fillim nga ora 15:00. Përballja tjetër është ajo në mes të Boreas dhe Z Mobile Prishtinës që do të luhet në Gjakovë të dielën duke filluar nga ora 19:00.

**TË SHTUNËN TAKOHEN:**  
15:00 Lipjani - Trepça  
19:00 Golden Eagle Ylli - Rahoveci

**TË DIELËN TAKOHEN:**  
17:00 Bashkimi - Ponte Prizreni  
19:00 Borea - Z Mobile Prishtina

## Nadali: Federeri është i jashtëzakonshëm në fushat me dhe

Madrid, 5 tetor - Roger Federeri në dy vjetet e fundit nuk ka luajtur asnjë ndeshje në fushat me dhe, një sipërfaqe ku ai zakonisht vuan shumë, aq sa në karrierën e tij ka fituar vetëm një herë në grand slam të Roland Garros, që luhet në këtë sipërfaqe. Edhe pse fitoret e zviceranit në fushat me dhë janë me pikatore, rivali i tij Rafael Nadal ka një tjetër konsideratë: "Rogeri është një kampion në fushat me dhë. Ka dalë pesë herë në finalen e Roland Garros, e ka fituar një herë si dhe mjaft turne në këtë sipërfaqe". "Federeri luan mjaft mirë në fushat me dhë. Unë nuk kam parë shumë tenistë që të arrijnë kaq shumë herë në finalen e Roland Garros sa ai, ndaj unë e konsideroj si një ndër më të mirët në këtë sipërfaqe. Ndoshta nuk është sipërfaqja e tij e



preferuar, por kur luan këtë gjë e bën vetëm për të fituar", ka deklaruar Nadal, që e mirëpret kolegun vitin tjetër në turneun parisien. "Kam dëgjuar që vitin e ardhshëm mund të luajë. Do të ishte fantastike, edhe pse për mua do të jetë një rival i fortë më shumë", u shpreh Nadali.

### SHKURT

#### Aksident i frikshëm i Lorenzos në Tajlandë

Jorge Lorenzo ka pësuar një aksident të frikshëm në provat e lira të dyta të Çmimit të Madh të Tajlandës. Në kthesën numër 3 në pistën Buriram është përfshirë në këtë aksident të rëndë, ende pa rikuperuar këmbën e djathtë nga dëmtimi në Aragon. Motori i tij, Dukati, çekulibrohet në mënyrë të menjëhershme, duke e fluturuar në ajër pilotin. Kontrollat e para mjekësore në qendrën e ndërhyrjes së shpejtë në pistë kanë kaluar me rezultate pozitive, megjithatë Lorenzo është drejtuar për në spital për një kontroll më të specializuar.

#### Ibra flet për rikthimin te Milani

Ditët e fundit mediet italiane raportuan se Zlatan Ibrahimoviçi do të kalojë në merkaton e janarit te Milanit, duke u rikthyer në Serinë A. Në vazhden e këtyre zërave është pyetur pikërisht gjiganti suedez, i cili vazhdon të jetë pjesë e skuadrës LA Galaxy në MLS. Si gjithmonë, Ibra godet dhe bën lajm me deklaratat e tij, kështu ka bërë edhe këtë herë. "E gjithë bota më dëshiron mua. Në rregull është", ka thënë Ibrahimoviçi, duke shtuar se zëra ka gjithmonë, por nuk e ka mohuar një rikthim të mundshëm te Milani.

#### Allegri: Ronaldo është një profesionist i madh

Trajneri i Juvnetusit, Massimiliano Allegri, e ka ripërsëritur se Cristiano Ronaldo është një djalos i shkëlqyer dhe shumë profesionist. "Ai është në rregull, e njoh atë tash e tre muaj. Në tërë këta 15 vjetet e karrierës së tij ai ka treguar profesionalizëm të madh jashtë dhe brenda fushës. Ai është i dedikuar, po ashtu, edhe në çështjet e shoqërisë. E dija se nuk do të ftohet nga Portugalia. Ai bëri marrëveshje me presidentin e federatës", ka thënë Allegri.

#### Hummelsi dëshiron të largohet nga Bayerni

Mediet gjermane kanë zbuluar se mbrojtësi Mats Hummels po mendon të largohet nga Bayern Munchen. Sipas shtypit gjerman, 29-vjeçarit duket se nuk i pëlqen rotacioni i kryer nga trajneri Niko Kovaç pas çdo takimi. Hummels iu ribashkua Bayernit në vitin 2016, nga Borussia Dortmund, ku ishte transferuar në vitin 2008, pikërisht nga "bavarezët", fillimisht në formë huazimi. Kontrata e tij me kampionët e Gjermanisë përfundon në vitin 2021, ndërkohë që për mbrojtësin për momentin asnjë skuadër nuk ka shfaqur interes.

#### Mançini lë jashtë Balotelin dhe rikthen në kombëtare Xhovinkon

Trajneri i Italisë, Roberto Mançini, ka bërë publike listën për dy ndeshjet e muajit tetor, miqësoren ndaj Ukrainës dhe përballjen ndaj Polonisë e vlefshme për Ligën e Kombeve. Mançini ka rikthyer në kombëtare Verratin, Xhovinkon dhe Aqerbin. Në kombëtare për herë të parë është thirrur edhe sulmuesi i Sampdorias, Kaprari.

Lista e futbollistëve: Kranjo, Donarumma, Perin, Sirigu, Aqerbi, Biragi, Bonuçi, Kielini, Krishito, D'Ambrosio, Emerson Palmeri, Florenci, Romanjoli, Barela, Bernardeski, Bonaventura, Galiardini, Zhorzhinjo, Pelegrini, Verrati, Berardi, Xhovinko, Kaprari, Kieza, Kutrone, Imobile, Insinje, Zaza.

#### Lopetegui: Nuk jemi në krizë, kemi mungesë fati

Trajneri i Real Madridit, Julen Lopetegui, nuk mendon se ekipi i tij është në krizë, pasi ka pikë të barabarta me liderin e La Ligas, teksa fajtor të disa rezultateve e lë edhe mungesën e fatit. "Ky është Real Madridi, është normale që do të ketë kritika. E rëndësishme është ndjeshmëria që kemi me djemtë. Do të ketë gjithmonë çaste të mira dhe të këqija. Do t'i rregullojmë ato që kemi për të rregulluar, por kemi besim se do të bëjmë më të mirën tonë në të gjitha garat ku luajmë", ka thënë fillimisht Lopetegui. "Aktualisht jemi me pikë të barabarta me liderin e La Ligas dhe kam besim se edhe në Ligën e Kampionëve do të kemi rezultate të mira. Mendoj se na ka munguar paksa fati, por nuk ka problem. Punojmë çdo ditë për t'u përmirësuar më shumë", ka deklaruar Lopetegui, i cili ka bërë me dije se Bale është i gatshëm për ta ndihmuar Realin në ndeshjen e radhës.



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada-Government  
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS  
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 552/1  
 Dt: 05.10.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Qendrën e Kompetencës në Malishevë Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren për vitin shkollor 2018/2019

Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës me (14 orë mësimore);	Vend i lirë për një (1) vit shkollor
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës me (14 orë mësimore);	Vend i lirë për një (1) vit shkollor
			1 (një) Mësimdhënës/e (me 10 orë mësimore); për lëndën e Mikrobiologjisë	Vend i lirë për një (1) vit shkollor
Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim

Sh.M.L	Qendra e Kompetencës	Malishevë	1 (një) Mësimdhënës/e me (10 orë mësimore); për lëndën e Gjuhës Gjermane;	Vend i lirë deri në përfundim të vitit shkollor
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës me (10 orë mësimore);	Vend i lirë deri në përfundim të vitit shkollor
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike me (20 orë mësimore);	Zëvendësim, deri në kthimin e mësimdhënësit nga pushimi pa pagës.
Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim

Sh.M.L.T	"11 Marsi"	Prizren	Një (1) mësimdhënës/c për lëndë profesionale për Dizajn me 20 orë mësimore;	Vend i lirë deri në përfundim të vitit shkollor
			Një (1) instruktor të trafikut rrugor	Vend i lirë për një vit shkollorë
			Një (1) instruktor të ndërtimit/arkitekturës	Zëvendësim deri nga kthimi i pushimit të lehonisë i mësimdhënës
Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Nëse punon me orar të plotë nuk ka të drejtë të punojë në ndonjë punë apo detyrë me pagesë nga Buxheti i Kosovës.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

#### Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlikime me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen dhe;
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe vizionit në krijimin dhe drejtimin e QK-së si një institucion që garanton cilësi të lartë, të cilat duhet të jenë parakushte themelore.

#### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 8 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi në (Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Qendrën e Kompetencës në Malishevë dhe Sh. M. L. 11 Marsi në Prizren). Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA**  
**ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Nr:551 /1  
Dt: 05.10.2018

Në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-149, neni 12, paragrafi 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur*

Departamenti: Drejtorati për fushat profesionale të AAP-së dhe ARr-së

Paga bruto: 423.85 €

Titulli i vendit të punës: Zyrar/e profesional (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: gjatë (6) mujore

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihej realizimin e aktiviteteve të AAAPARr-se në bazë të planit vjetor dhe legjislacionit në fuqi për punën profesionale.
- Në konsultim me stafin profesional dhe mësimdhënësit e shkollave partnere të marrë të dhëna të reja për zbatimin e kurrikulave, sfidave dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre.
- Të ndihmoj në organizimin e trajnimeve të mësimdhënësve të parapara sipas planit të veprimit.
- Të ndihmoj në organizimin e punësive, konferencave.
- Bashkëpunon ngushtë me stafin AAAPARr-së për çështje profesionale në AAP dhe komunikon me bartësit relevant brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen në fushën e AAP-së.
- Kryen edhe punë tjera të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Përgjegjës për raportim të punës të përgjegjësi kompetent për dhënien e shënimeve dhe raporteve lidhur me të gjitha kërkesat e pranuar dhe për parregullsi eventuale;
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access);
- Diplomë universitare .

### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendrike nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (Ndërtesa MASH-T-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë), duke filluar nga ora 8.00 deri në orën 16.00 po ashtu aplikacionet e plotësuar, duhet të dërgohen në këtë adresë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike, Ibër-Lepenc" S.H.A. – Prishtinë, publikon këtë:

## KONKURS

### 1. Zyrar i prokurimit (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë së këtij zyrtari do të jenë si vijim:

- Bën pranimin e kërkesave për prokurime;
- Punon në platformën elektronike të Prokurimit – eProkurim;
- Në bazë të kërkesave inicon procedurat e prokurimit, varësisht nga vlera e tenderit dhe bën përgatitjen e dokumenteve të tenderit;
- Realizimin e kërkesave dhe nënshkrimin e kontratave (në mungesë të Drejtorit);
- Hapje te ofertave;
- I ndihmon komisionet vlerësues në kontrollimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave;
- Për punën e vet raporton dhe i përgjigjet Drejtorit të Prokurimit;

